

KOHA

Favore

Podgoricë e enjte, 18 prill 2024 Viti XXIII Numër 1106 Çmimi 0,50

Masakra e Tivarit dhe rishkrimi i historisë

Kosova, djep i diturisë dhe identitetit kombëtar



Humanistët më të zellshëm të njerëzimit ndër shekuj





10

Tallava muzika dhe politika shqiptare



14

Dr. Athanas Gegaj pohon se Kastriotët ishin një racë e pastër arbërore



16

Ditët e tmerrit për inteligjencën e arsimit shqip në Ulqin



18

Oazë e dijes dhe e shpresës



KOHA
Javore

Themelues: **Kuvendi i Malit të Zi**

Gazetë javore për aktualitete, shkencë dhe kulturë, Numri i parë doli më 21 shkurt 2002.

Botues: **Këshilli Kombëtar i Shqiptarëve**

Redaktor Përgjegjës: **Qani Osmani**

Gazeta redaktohet nga kolegji i:

Fahrudin Gjokaj (Redaktor Teknik & Sistem Inxhinjer)

Ismet Kallaba (aktualitete, sport),

Toni Ujkaj (kulturë)

Vijoleta Berishaj (sekretare)

Adresa: Kral Nikolla 27a/4, Podgoricë 81000, Mali i Zi

Telefon: 020/240-659

E-mail: kohajavore@t-com.me

www.kohajavore.me



20

Në çfarë kohe jetojmë?



22

Të bashkëjetosh me dhimbjen e një fëmije me autizëm



28

Ëndrra e kapedanit



30

Nga fillim i vitit, fitues i dyzetë medaljeve



ARKIVI: www.kohajavore.me



Ministri i të Drejtave të Njeriut dhe Pakicave, Fatmir Gjeka, vizitoi Këshillin Kombëtar të Shqiptarëve në Tuz

KKSH të hapë z e vet edhe në T

Ulqin - Ministri i të Drejtave të Njeriut dhe Pakicave, Fatmir Gjeka, i shoqëruar nga sekretari shtetëror Astrit Hoxha dhe drejtori i Drejtorisë për Mbrojtjen dhe Avancimin e të Drejtave të Popujve Pakicë, Arben Xhurreta, vizituan të hënën (15 prill

2024) Këshillin Kombëtar të Shqiptarëve në Malin e Zi, ku u njohën për së afërmi me punën dhe aktivitetet e këtij institucioni përfaqësues të shqiptarëve. Kryetari i KKSH-së, Faik Nika, e njoftoi ministrin Gjeka me prob-

lematikat me të cilat përballet KKSH në veprimtarinë e vet dhe planet për të ardhmen.

Duke vlerësuar punën e deritashme të KKSH-së, ministri Gjeka potencoi mes tjerash nevojën që krahas zyrave koordinuese në Tuz



shqiptarëve në Malin e Zi dhe Librarinë “Ulqini”

zyrën Tivarit



dhe Plavë, KKSH të hapë zyrën e vet edhe në Komunën e Tivarit, në mënyrë që përmes aktiviteteve të saj për komunitetin shqiptar të kontribuojë në parandalimin e asimilimit të mëtejshëm të shqiptarëve në këtë komunë.

Ministri Gjeka dhe bashkëpunëtorët e tij vizituan po ashtu edhe Librarinë “Ulqini”, e cila është themeluar nga KKSH, me ç’rast biseduan me drejtoreshën Arlinda Osmani për aktivitetet e realizuara në promovimin e vlerave kulturore dhe krijuese.

Ai ka vënë në dukje nevojën e punësimit të paktën edhe të dy personave të tjerë në këtë librarë, si institucion të rëndësishëm dhe të nevojshëm jo vetëm për banorët vendas por edhe për turistët e shumtë që vizitojnë Komunën e Ulqinit.

i. k.

Masakra e Tivarit dhe rishkrimi i historisë

(Me rastin e 79-vjetorit 1945-2024)

Ndër ngjarjet tragjike të popullit shqiptar që ka të bëjë me Luftën e Dytë Botërore është Masakra e Tivarit, e cila ka ndodhur me 1 prill 1945. Në këtë masakër të realizuar nga njësitë ushtarake të Jugosllavisë, janë likuiduar një numër i madh shqiptarësh nga Kosova, me përmasat e gjenocidit, të cilët ishin mobilizuar për të ndjekur okupatorët gjermanë në pjesën perëndimore të ish-Jugosllavisë. Mobilizimi i tyre në Kosovë ka pasur një prapavijë të caktuar politike, sepse si qëllim kishte spastrimin e Kosovës nga shqiptarët, për të realizuar në praktikë pushtetin ushtarak i cili ishte vendosur nga data 8 shkurt 1945, duke bërë riokupimin e Kosovës, pa përfillur parimet e Kartës së Atlantikut, me pasoja për shqiptarët që është dëshmuar në vitet vijuese



Nail Draga

Me 1 prill u bënë 79 – vjet (1945-2024) nga Masakra e Tivarit, ku u likuiduan në mënyrën më mizore shqiptarët nga Kosova. Sipas të dhënave del që ky numër të përfshijë të paktën 1560 shqiptarë, ndërsa sipas disa përlogaritjeve arrin deri në 3764 persona. Fjala është për shqiptarët të cilët ishin të mobilizuar si regrutë në aradhat partizane, për të ndjekur armikun përfundimisht nga territori i ish-Jugosllavisë. Por, edhe pas shtatëdhjetë e pesë vjetëve kjo tragjedi ende nuk është ndriçuar nga studiuesit e ndryshëm nga vetë fakti se gjatë periudhës së sistemit komunist marrja me një ngjarje të tillë s'ishte e preferuar dhe kishte pasoja për autorët.

Edhe pse në popull dihej për këtë tragjedi dhe pëshpëritej për numrin e të vvarëve, saktësisht pak kush dinte

të dhëna të sakta, sepse arkivat për shqiptarët ishin nën embargo, madje dokumentet gjegjëse ka mundësi që janë zhdukur nga ato të cilat kanë realizuar këtë masakër.

Dëshmi autentike e atyre që përjetuan masakrën

Por, vetëm pas dështimit të sistemit monist dhe vendosjes së pluralizmit nga viti 1990, opinioni i gjerë filloi të njihej më në detaje për këtë masakër, e atë duke iu falënderuar dëshmitarëve autentikë të cilët kishin shpëtuar nga kjo kasaphane tipike naziste e bërë nga pjesëtarët e aradhave partizane jugosllave, gjoja "nacional-çlirimtare". Dhe janë këta individë që e përjetuan personalisht këtë masakër, ata të cilët kanë dhënë kujtimet e tyre për këtë kalvar të shqiptarëve nga mobilizimi i tyre në Kosovë dhe rrugëtimi në relacionin Prizren-Kukës-Shkodër-Tivar.

Ndër ta bën pjesë edhe Azem Hajdini – Xani, i cili opinionit i ka dhuruar librin "Tragjedia e Tivarit", botuar në Shtutgard në Gjermani në vitin 1990 dhe më pas ribotuar në Prishtinë në vitin 1998. Po ashtu ky autor ka botuar edhe një botim tjetër me titull "Masakra e Tivarit" - Memoare, Prishtinë 1998,

duke prezantuar dëshmi autentike të personave të cilët kanë mbetur gjallë. Edhe pse ndërkohë janë botuar edhe disa studime nga autorë të tjerë për këtë masakër (M.Pirra, U.Butka etj.), botimi i këtyre materialeve nga autori i cili e ka përjetuar drejtpërdrejt këtë masakër për momentin shërben si lëndë bazë dhe e domosdoshme për ta trajtuar këtë tragjedi të bërë nga komunistët, në prag të përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, sepse arkivat ende janë të mbyllura për hulumtuesit shqiptarë.

Nisja nga Prizreni për në Tivar

Për ta bërë plotësimin e Armatës IV të Jugosllavisë, për në Frontin VP të bregdetit të Adriatikut në sajë të dhënave të publikuara del se në mars dhe prill të vitit 1945, u deportuan 22.017 luftëtarë shqiptarë nga Kosova. Ata janë deportuar në formacione ushtarake të cilat quhen eshalonë, që gjatë muajve mars-prill 1945 nga Prizreni për në Tivar gjithsej ishin gjashtë eshalonë të tillë. Kështu në mars janë deportuar tre eshalonë: Eshaloni i parë, me 3.700 luftëtarë, ishte nisur nga Prizreni më 24.3.1945 dhe kishte arritur në Tivar më 29.3.1945; eshaloni i dytë, më



4.700 luftëtarë, ishte nisur nga Prizreni më 26.3.1945 dhe kishte arritur në Tivar më 31.3.1945 dhe eshaloni i tretë me 2.700 luftëtarë shqiptarë, ishte nisur nga Prizreni më 27.3.1945 dhe kishte arritur në Tivar më 1 prill 1945. Ndërsa, gjatë muajit prill janë deportuar edhe tre eshalonë të tjerë: eshaloni i parë me 1.506 luftëtarë ishte nisur nga Prizreni më 19 prill 1945, eshaloni i dytë me 2.601 luftëtarë ishte nisur nga Prizreni më 20 prill 1945 dhe eshaloni i tretë me 1.216 luftëtarë ishte nisur nga Prizreni më 24 prill 1945. Ndërsa, më pas nga Prizreni ishte nisur një eshalon i veçantë me 5.323 luftëtarë shqiptarë, nga Maqedonia në ditët e para të prillit të vitit 1945.

Pse po largoheshin luftëtarët nga Kosova

Duke marrë parasysh se operacionet luftarake kundër nazistëve gjermanë në Luftën e Dytë Botërore kishin marrë fund nga fundi i viti 1944, me të drejtë bëhet pyetja se pse i deportuan luftëtarët shqiptarë nga Kosova. Përgjigja ishte e qartë sepse planifikohej një hakmarrje ndaj shqiptarëve të Kosovës për humbjen që kishin përjetuar formacionet ushtarake të partizanëve jugosllavë në luftën ndaj luftëtarëve të Shaban Polluzhës. Ndërsa, nga ana tjetër, si qëllim ishte largimi nga Kosova i atyre luftëtarëve të cilët mund të bëjnë rezistencë për vendosjen e pushtetit ushtarak serb, gjegjësisht ripushtimin serb të Kosovës, në sajë të vendimeve të mëvonshme.

Të mobilizuarit iu ngjanin robërve

Edhe pse të gjithë të tubuarit nga ana të ndryshme të Kosovës kishin premtime se do të deportoheshin me sta-

tusin e luftëtarëve për ta ndjekur armikun në vinë e frontit në veriperëndim të Adriatikut (Istër-Siloveni), nga momenti i parë në Prizren u vërejt se do të jetë tërësisht ndryshe. Nëse deri aty ata ishin të armatosur dhe në përcjellje të oficerëve shqiptarë, me t'u nisur nga Prizreni përcjelljen e morën oficerët serbo-malazezë, ndërsa po ashtu u detyruan për të dorëzuar armët, me pretekst se rruga është e gjatë dhe do të lodheni pa nevojë, pra, ata u nisën nga Prizreni të paarmatosur, të paushqyer, të lodhur, të paveshur dhe në kushte higjienike të papërshtatshme. Ishte ky eshaloni i dytë që ishte nisur nga Prizreni më 26 mars, ku pjesëtarët e tij do të përjetonin gjenocid të paparë në qytetin e Tivarit të Ri.

Gjatë rrugës atyre iu ndalohej dalja nga kolona, qoftë për të pirë ujë apo kryer nevoja fiziologjike. Kush kishte guxim të vepronte ndryshe e pësonte me jetë, sepse pushkatohej në vend. Nga një sjellje e tillë e oficerëve përcjellës të cilët vrisnin kur kishin dëshirë e flisnin fyerjet më vulgare ndaj shqiptarëve, tash të gjithë e kishin të qartë se nuk janë më luftëtarë por iu ngjanin robërve të luftës. Dhe nga një situatë e tillë dramatike gjatë rrugës deri në Shkodër, numri i të vrarëve kishte arritur deri në 800 luftëtarë të cilët janë gjuajtur në lumin Drin, Bunë etj..

Pamjet e Tivarit para-lajmëronin masakrën

Me të arritur në Tivarin e Ri është vërejtur një mobilizim i madh i popullatës vendore, ku me ta ishin së bashku edhe njësitë ushtarake të Brigadës së Dhjetë malazeze, të armatosur në çdo aspekt, athua se janë duke pritur njësitë e armikut. U pa qartë komploti dhe gracka e përgatitur, por ata prisnin

vetëm shkakun. Në qendër të Tivarit të Ri, pasi i kanë urdhëruar për të pushuar, në afërsi të tyre ishte një krua, ku shqiptarët shprehën kërkesën për të pirë ujë, por oficerët reagueshëm, duke mos iu mundësuar dhe duke i fyer ata në aspektin nacional, duke vrarë tre shqiptarë, ndërsa nga plumbat e tyre kishin vrarë "gjoja" një ushtarë malazias. Ky ishte një tjetër pretekst për të vrarë shqiptarë, andaj për ketë "vepër", e cila nuk ishte bërë nga shqiptarët, ata pushkatuan 100 ushtarë shqiptarë, sikurse nazistët gjermanë kohë më parë. Nga kjo e papritur shqiptarët ishin të vetëdijshëm se një tragjedi e tillë nuk do të përfundojë me kaq, sepse ishin të rrethuar nga të gjitha anët.

Ndërtesa e Monopolit të Duhanit, ferri i shqiptarëve

Ata më pas në kolonë i detyruan të ecin dhe i vendosën në objektin e Monopolit të Duhanit në afërsi të portit. Ishte kjo një ndërtesë trekatëshe, ku i detyruan të hyjnë brenda, ndërsa të tjerët u vendosen në oborr, pra të gjithë grumbull e jo në kolonë, sepse kështu mundësia për t'i shfarosur ishte më e madhe. Dhe nuk ka vonuar shumë, te të gjithë shqiptarët, si brenda në ndërtesë, ashtu edhe në oborr, ishte gjuajtur me të gjitha mjetet luftarake rreth dy orë dhe në oborr dhe shesh ku ishin rreth 3000 veta nuk kishte mbetur njëri i gjallë në këmbë, sepse ishte bërë kasaphanë e vërtetë dhe kudo ishte lumë gjaku. E tërë kjo masakër ka zgjatur rreth një orë e gjysmë, duke filluar në ora 14 të datës 1 prill 1945. Patën fat të shpëtosh vetëm ata që ishin në katin e lartë të ndërtesës dhe disa nga eshaloni i parë, të cilët për momentin ishin në Tivarin e Vjetër. Por, tragjedia ishte ndërprerë, duke iu falënderuar disa vëzhguesve amerikanë, të cilët kishin kaluar atypari me automobili dhe me gjasë kishin dëgjuar të shtënat e armëve dhe kishin ardhur për ta parë vendin e ngjarjes. Por, kriminelët iu dolën përpara dhe i bindën të largoheshin dhe ta vazhdojnë rrugën për në Ulqin. Pra, nga frika se do të zbulohet krimi, ata u detyruan ta ndërpresin lojën. Ishte kjo një rastësi që të shpëtoshin disa luftëtarë kosovarë, të cilët do të jenë dëshmitarë të kësaj masakre, edhe pse qëllimi i forcave shfarosëse të partizanëve jugosllavë ishte për t'i vrarë të gjithë, për të mos pasur dëshmitarë.

(Vijon)

Kosova, djep i diturisë dhe identitetit kombëtar

(Vijon nga numri i kaluar)

Akti i dytë- Prishja e marrëdhënieve Jugosllavi-Shqipëri dhe shkollimi në Kosovë

Shqiptarët në Mal të Zi, siç kemi cekur, përveç jetës ekonomike me Shkodrën ishin të lidhur edhe për interesat e zhvillimit arsimor, kulturor dhe ruajtjes të identitetit kombëtar. Në fillim, sidomos gjatë viteve 1945, 1946, kur vazhdonte hapja e shkollave në gjuhën shqipe, librat, lektyrat shkollore dhe gazetatat në gjuhën shqipe sillleshin kryesisht nga Shkodra. Madje nga Shkodra vinin edhe ligjërues të ndryshëm për çështje politike, sepse popullata shqiptare në Mal të Zi, sidomos zonat fshatare, nuk e flisnin e as e kuptonin gjuhën serbe, rrjedhimisht as ligjëratat partiake. Pas ndërprerjes së marrëdhënieve shtetërore Shqipëri-Jugosllavi një gjë e tillë nuk do të jetë më e mundur! Për shqiptarët në Mal të Zi kjo ishte e rëndë, së pari sepse kishte vetëm dy-tre vjet që në shkollat fillore mësimi zhvillohej në gjuhën shqipe dhe së dyti kthimi i shkollave në gjuhën serbe për shkak të mungesës së literaturës ose kuadrove shqiptare do të ishte vdekje për ata. Por pas çdo të keqeje vjen edhe një e mirë. Kosova i hapi dyert e shkollave të mesme edhe për shqiptarët në Mal të Zi, kështu që u bë i mundur sigurimi i kuadrove profesionale, jo vetëm në arsim por edhe në ekonomi, prodhim apo shëndetësi. Kosova që ishte aq larg tani, më ishte aq afër sepse ku të shkonim tjetër s'kishim. Të rinjtë shqiptarë nga Mali i Zi u nisën për herë të parë për

Kosovë në vitin 1948 dhe u regjistruan në shkollën normale në Gjakovë, për të vazhduar pastaj në Prishtinë ku morën diplomat për mësues. Gëzimi ishte i madh jo vetëm për të diplomuarit dhe prindërit e tyre por për gjithë shqiptarët, sepse në shkollat fillore për herë të parë do të japin mësim bijtë tanë, pra kuadrot shqiptare nga Mali i Zi. Të rinjtë shqiptarë nga Mali i Zi, pastaj u regjistruan edhe në shkollat tjera profesionale si: ekonomike, teknike, bujqësore, në mjekësi etj.. Dhe tash jo vetëm në qytetet e përmendura, por edhe në Pejë, Prizren, Ferizaj, Mitrovicë, edhe në Gjilan e Vushtrri, pra kudo në Kosovë.

Para se të fillonin të ndjekin mësimin shqip në Kosovë, ishin të paktë nxënësit shqiptarë nga Mali i Zi, por as të rriturit, që dinin diçka më shumë për historinë dhe letërsinë shqiptare, për simbolet tona apo identitetin kombëtar shqiptar. Ato nuk kishin njohuri për Isa Boletinin apo Shote Galicën, Bajram Currin e Azem Bejtën, Hasan Prishtinën e shumë pak dinin edhe për Emin Durakun, Mastafë Bakinë apo Ramiz Sadikun. Nuk kishin dëgjuar për Fan Nolin, Gjergj Fishtën, Faik Konicën, Sterjo Spasën e shumë të tjerë. Po ashtu nuk dinim as për Skënderbeun e as për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit. Me të ardhur në Kosovë nxënësit shqiptarë nga Mali i Zi filluan të lexonin romane, drama e përralla në gjuhën shqipe. Veprat e disa nga figurat e përmendura ishin të ndaluara edhe në Kosovë, por njohuri kishte dhe disi mund të lexoheshin. Këtu mësuan për format dhe dukjen e flamurit

shqiptar sepse në Mal të Zi nuk na e kishte përmendur kush, për identitetin kombëtar dhe rëndësinë e ruajtjes së tij. Shumë studentë pas diplomimit u kthyen në vendlindjen e tyre duke dhënë kontributin e tyre në arsimimin e brezave të rinj, duke përcjellë te ata jo vetëm njësitë mësimore, por edhe atdhedashurinë, njohuritë për kombin dhe kombësinë shqiptare. Disa nga ata vazhduan të punojnë e jetojnë në Kosovë. Sot në Kosovë, me prejardhje nga Mali i Zi ka shumë profesorë, juristë, ekonomistë, inxhinierë, mjekë, shkrimtarë, doktorë shkencash e akademikë. Përveçse mësonin në gjuhën e tyre amtare, shqiptarët nga Mali i Zi në Kosovë filluan ta ndiejnë veten shpirtërisht të lirë, duke folur shqip kudo në klasë, librari, teatër, autobus, tren apo rrugë, në fushën sportive e kudo tjetër. Këtu ata mund të lexonin gazetatat në gjuhën shqipe e të dëgjonin po ashtu në gjuhën shqipe Radio Prishtinën. Po mos të ishte Kosova arsimim në gjuhën shqipe nuk do të kishte, asimilimi i filluar që nga Mbretëria Jugosllave do të fuqizohej e si rrjedhojë vendet shqiptare do të asimiloheshin e do të boshatiseshin shumë më shpejt.

Për të gjitha këto që përmendëm, Kosova për shqiptarët në Mal të Zi është më shumë se fjala Kosovë. Në të vërtetë ajo është djep i arsimit, sepse aty u shkolluan, është djep i lirisë shpirtërore, sepse aty për herë të parë e ndienim vetën të lirë kudo dhe së fundmi është djep i vetëdijes kombëtare, sepse aty u njohëm me historinë dhe simbolet tona kombëtare, pra u formësuam

ëtar



kombtarisht, përndryshe me politikën që ndiqte Mali i Zi ndaj shqiptarëve procesi i asimilimit do të kishte përfunduar që moti. Falë Kosovës qenia shqiptare në Mal të Zi ekziston edhe sot e kësaj dite.

Cilindo shqiptarë nga Mali i Zi, që u shkollua në Kosovë, ta pyesësh për përkatësinë apo identitetin kombëtar, do të marrësh vetëm një përgjigje: “Në Kosovë u formësuam kombëtarisht! Për këtë arsye e shumë të tjera Kosovës i kemi shumë borxhe”.

Shkollimi i shqiptarëve në Kosovë u bë halë në sy për politikën dhe pushtetin e Malit të Zi, e cila do të tregohej aq e ashpër ndaj shqiptarëve, të cilët për çështje politike u dënuan me më shumë se 360 vite burg. Megjithatë, kjo nuk i ndaloi shqiptarët të kërkonin më shumë të drejta civile dhe politike, përkundrazi, ata i nxiti edhe më shumë.

Akti i tretë - Pavarësia e Kosovës

Pas ngjarjeve në Kosovë në vitin 1981, edhe për shqiptarët në Mal të Zi filloi një periudhë e errët dhe e vështirë, sidomos për ata që guxonin të flisnin apo të kërkonin të drejtat e tyre kombëtare si individ apo komunitet. Në shënjestrën e politikës antishqiptare, kryesisht ishin intelektualët, veçanërisht punëtorët e arsimit, por për të arritur qëllimin nuk u kursyen as fshatarët, madje as punëtorët e krahut. Shqiptarët largoheshin nga puna, denoncoheshin e dënoheshin për vepra penale të propagandës armiqësore dhe nxitjen e urrejtjes, përçarjes dhe mostolerancës nacio-

nale, racore dhe fetare, kundër popullit dhe shtetit apo bashkimit kundër popullit dhe shtetit.

Masat e dhunshme në Kosovë, heqja e autonomisë së saj, largimi i punonjësve arsimorë e të tjerëve nga puna dhe mbajtja e mësimit nëpër shtëpi e objekte tjera private u përjetua keq ndër shqiptarët në Mal të Zi. Vijimi i shkollimit në Kosovë po vështirësohej shumë. Nxënësit e studentët shqiptarë nga Mali i Zi në stacionet policore në Zubin Potok ndaloheshin e keqtrajtoheshin. Vajtje-ardhja në Kosovë ishte e rrezikshme. Numri i shkollarëve që vazhdonin në Kosovë po zvogëlohej saqë në vitet shkollore 1991 dhe 1992 u regjistruan shumë pak, ose aspak studentë shqiptarë nga Mali i Zi. Rruga e mbarë e shkollimit në Kosovë pothuajse përfundoi, e kjo paraqiste rrezik për popullin shqiptar në Mal të Zi. Kërcënohej rreziku se do të mbesin shkollat pa mësues a profesorë, ekonomistë e juristë, pa mjekë të shkolluar në gjuhën shqipe. Shqiptarët e dinin se ky ishte qëllimi i pushtetit malazez, prandaj ekzistonte droja se po na ktheheshin kohët e vjetra, të vështira, po rrezikohej identiteti kombëtar shqiptar. Dhe kështu do të ndodhte, sikurse mos të hapej një derë e re në shtetin amë – Shqipëri. Në vitin shkollor 1993/1994 për herë të parë studentët shqiptarë nga Mali i Zi u regjistruan në universitetet shqiptare dhe kështu u sigurua vijueshmëria e studimit shqip.

Vitet 1998/1999, nga çdo shqiptar do të mbahen mend si vitet e gjenocidit të Serbisë ndaj shqiptarëve në

Kosovë. Shqiptarët u detyruan t'i lëshonin shtëpitë e tyre dhe Kosovën. Shqiptarët në Mal të Zi kudo, në Ulqin, Krajë, Malësi, Rozhajë, Plavë e Guci i hapën dyert dhe strehuan motrat e vëllezërit e tyre kosovarë, duke iu lehtësuar sadopak vuajtjet e dhimbjet që po i përjetonin.

Kosova u çlirua, gëzimi ishte i madh. U gëzuan për vëllezërit kosovarë edhe shqiptarët në Mal të Zi. Komunikimi me Kosovën u vendos përsëri. Nuk kaluan shumë vjet dhe përsëri studentët shqiptarë nga Mali i Zi vazhduan e po vazhdojnë të mësojnë e studiojnë në Kosovë. U lidhën miqësi të reja, ndodhën fejessa e martesat me njëri tjetrin. Sado që Shqipërinë gjeografikisht e kemi më afër, Kosovën falë të gjitha atyre që i kemi cekur më lart, por edhe për rrjedhat e reja shoqërore që po ndodhin, më duket se e kemi më afër. Kosova është e lirë. Ne u rikthyem në Kosovë. Shqiptarët në Mal të Zi tanimë kanë edhe një shpresë tjetër, kanë Kosovën. Ata janë fatlumë që Kosova u bë shtet i pavarur. Përsëri, nxënës e studentë do të shkollohen në Kosovë, disa do të kthehen të diplomuar në vendlindje e të tjerët do të mbesin atje për të begatuar më shumë skenën intelektuale kosovare, ashtu si bënë edhe më parë. Historia po përsëritet, djepi i arsimit, lirisë shpirtërore dhe identitetit kombëtar – Kosova i ka dyert e hapura për shqiptarët në Mal të Zi, ndërsa atyre u mbetet të reflektojnë. Asgjë nga e kaluara nuk duhet të harrohet apo të fshihet, përkundrazi, e mira duhet të kultivohet e të jemi falënderues.

Tallava muzika dhe politika shqiptare

Fjala “tallava” është një fjalë e pakuptimtë, një fjalë që çuditërisht lehtë depërtoi në të folmen shqipe. Kjo fjalë përdoret në “artin muzikor”, në muzikën popullore sentimentale, të cilën, në anën tjetër, sllavët e kishin quajtur “turbo-folk”. Një melodi me nota muzikore serbe, me ritëm grek, me instrumente turko-arabe, me formën e këndimit rom, me tekste të përkthyer nga indishtja, e kënduar nga një pseudo-këngëtar shqiptar! Kjo është tallava!



Qani Osmani

Fenomeni “tallava” shpreh tendencën “e globalizimit” allaserbçe të muzikës që kultivohet në Ballkan, shtrirjen e bastardimit të muzikës popullore deri në përmasat e imponimit të një lloj vlere që mund të jetë e pranueshme vetëm për shpirtin zombie.

Fatkeqësisht, plagjiatura, kompilimi muzikor si dhe përpjekja për imitim janë karakteristikë e tallavasë, ndërsa piku i tragjedisë arrihet kur bartës të këtij fenomeni nisin të bëhen “vip”-at, d.m.th estrada kombëtare (ne paskemi estradë?!) dhe kur tërë kjo fatkeqësi kombëtare nis dhe emotohet nga televizionet kombëtare.

Pra, pa dyshim, ky fenomen tashmë ka gjetur edhe përkrahje institucionale shtetërore! Kësisoj, pa fije hamendësimi mund të konstatojmë se, sot, kemi një shtresë të gjerë të popullatës me shije të topitur muzikore, me nevojë shpirtërore për t’u dëfryer me “muzikën” pleh, për t’u identifikuar me krenari kombëtare me një “muzikë” që ta mbyl ngadalë identitetin muzikor, që të hedh pikë gjigante të helmit në botën e madhe kulturore kombëtare.

Në botën perëndimore, sidomos në Evropë, kah fillimi i rrymave të reja të artit (“neo...”), u shfaqën edhe dy dukuri me të cilat sot emërtohen antivlerat: shund-i, “arti pleh”, që në gjuhën më të butë i themi “limonadë”, si dhe kiç-i, “arti” i bazuar në kopje, në imitim inferior, në ndrydhjen e shijes deri ne pikën e bezdisë, por që u karakterizua me një hov komercial. Në momentin kur bota perëndimore ndjeu rrezikun nga këto dy dukuri që po imponoheshin për t’u pranuar si kategori arti me një filozofi të re të neolëvizjeve artistike, ndërsa në mendimin politik po përpiquej ta ngjizë tezën se edhe politika duhet të jetë imitim, ndaj dhe çdo gjë duhet të jetë integruese dhe e integruar në natyrë sipas Ligjit të “Më të Madhit”, atëherë, si kiç-i ashtu edhe shund-i u përfshinë në lëndët adekuate si materie studimore me qëllim që të sinjalizohen rreziqet që i kanosen artit, estetikës, mendimit të mirëfilltë kombëtar.

Pa dyshim, tallava-tendenca duhet të studiohet, të kapet në rrënjë dhe edhe qimet rrënjore t’i shkurtohen nëse dëshirojmë të shpëtojmë nga projektet e huaja për integrimë shpirtërore!

Sot asnjë televizion nacional shqiptar nuk e emiton një këngë të Nexhmie Pagarushës! Ish-presidenti i shtetit shqiptar dekoron me medalje Bujar Qamilin, ndërsa kurrë nuk ka dëgjuar

për Qamilin e Vogël!

Vlerë konsiderohet ritmi, ai ritëm që mundëson lëvizje apo hapa ritmike, karakteristikë për të gjitha llojet e muzikës ballkanike e lindore. Dikush mendon se kjo politikë kulturore asimiluese është në harmoni me përpjekjet integruese! Kjo filozofi e prodhon edhe konceptin politik i cili rëndë e cenon kontekstin kombëtar. Integrimi nënkupton asimilim!

Le ta lokalizojmë problemin dhe për këtë fenomen të flasim vetëm ndër ne, ndër shqiptarët e Malit të Zi! Nuk kemi kritikë, nuk kemi eseistë, nuk kemi vlerësues, ndërsa kemi një masë të gjerë shqiptarësh të cilët konsumojnë “art”, të cilët e prodhojnë “artin” (kemi shumë “këngëtarë”, “shkrimtarë”, “piktorë”, “shoqata shkrimtarësh”, “shoqata botuesish” etj.); kemi një popull që merret me “politikë”!

Cila është shija e kësaj mase konsumuesish e prodhuesish? Pëlqehet çdo gjë që është e huaj! Kjo tendencë e integritit të gjithanshëm, apo e asimilimit të mirëfilltë sot kumbon në radio, në televizione lokale e nacionale, madje me të madhe subvencionohet edhe nga institucionet e ndryshme shtetërore.

Kjo shtresë e popullatës më lehtë e ka të turqëzohet, të arabizohet, të shkinzohet, të integrohet, se sa të shndërrohet në pararoje e kështjellës gjigante të vlerave tona të mirëfillta



kombëtare. Kur të kaplon antivlera edhe tradhtia dhe asimilimi mund të konsiderohet “art” që ushtrohet nën petkun e porosive fetare apo edhe të integritimeve të gjithmbarshme.

“Tallava” politika, që janë duke bërë partitë politike shqiptare, është veprimtaria më e parapëlqyer në shoqërinë shqiptare e veçmas në Mal të Zi. Kjo ndodh mbase, te ne që moti nuk vlerësohen vlerat intelektuale, morale, kombëtare dhe përgatitja shkollore, por librezat partiake që individi ka në xhep, librezë që ia mundëson të mos jetë e rëndësishme çka ke në kokë, por cilës parti i përket dhe cilën emblemë partiake e ke si shenjë njohëse! Pra, kjo ndodh mbase politika edhe të pavlerin, nga “askushi” e bën të jetë “dikushi” dhe nga anonimi, të ngre në rrafshin e të famshmit të fisit, mëhallës, fshatit, qytetit etj..

S'ka dyshim se “tallava” politika që e praktikojnë partitë shqiptare, ka edhe një të mirë shumë të rëndësishme: nga njeri batakxi dhe barkëthatë, të shndërron në politikan të llojit të vet, ngutshëm të shndërron në më të pasurin e fisit dhe mëhallës. Pra, atyre të cilëve dikur iu kërcisnin zorrët e uritura, nuk e kanë më problem si të ngopen me një byrek, por preokupim të vetëm ta kenë si t'u takojë një copë sa më e madhe e kulaçit të pushtetit. Andaj, duke jetuar në një shoqëri ku veprimtaria më e preferuar e më fit-

imprurëse mbetet ajo që të siguron famë dhe pasuri të shpejtë, nuk është e rastit që të parapëlqyerit e partive politike shqiptare janë “trtrashërit, servilët, dhe sahanlëpirësit” të cilët posa bëhen të fortë e të famshëm, gjënë e parë që duan ta bëjnë, është të përbuzin dhe të nënçmojnë shokët dhe popullin që i kanë ndihmuar të bëhen politikan si dhe, ta marrin në duar, e të mos ndajnë me askënd, partinë e cila i ka lindur. Këta politikanë partitë politike i kanë shndërruar në kompani private dhe grupe ekskluzive të interesit në emër të demokracisë dhe patriotizmit. Këta oligarkë partiakë mendojnë se partia është vetëm e tyre dhe bazën e kanë në teorinë Staliniste “Ke pushtet, ke gjithçka”.

Shpjegimi i këtij fenomeni nuk është i komplikuar, kur dihet fakti se partitë politike shqiptare kryesisht janë shndërruar në strehimore të individëve të pasukseshëm në profesionet e tyre, kuptohet me ndonjë përjashtim të vogël. Këto parti politike kanë marrë trajtën e strehimores të njerëzve që ngutazi i kompensojnë të gjitha humbjet jetësore dhe ku nga “askushi” mund të bëhen “dikushi”. Andaj, jo rastësisht partitë politike shqiptare në Mal të Zi, janë shndërruar në shtabe, që pjellin patriotë të rrejshëm. Këtë fenomen e dëshmon edhe vet fakti se si po bëhen ashtu edhe zhbëhen.

Sidoqoftë, patriotët tonë politikë, politikën e konsiderojnë si veprimtari më të lehtë, me të cilën mund të merret cilido individ. Shembull konkret për këtë janë parti të panumërta të ndara në pjesën “me vulë” dhe atë “pa vulë”. Gjë që popullit ia pasqyron të vërtetën se drejtuesit e tyre partiakë, së bashku me vulën e partisë në xhep, në ballë e kanë të vulosur edhe njollën e paturpësisë, që u takon atyre që harrojnë se pa votën e mbështetësve partiakë, vështirë se dikush do e dinte se edhe ata jetojnë në mjediset tona.

Prandaj, lehtësia me të cilën themelohen partitë politike shqiptare, si dhe lehtësia me të cilin lindin dhe zhbëhen “heronjtë” tanë politikë dhe liderët partiakë, shpalos të vërtetën se politikën e konsiderojnë si veprimtari me të lehtë. Në të njëjtën kohë, kjo shpjegon edhe faktin se edhe ne votuesit jemi të papërgjegjshëm ndaj vetvetes dhe i mbështesim edhe ata politikanë të cilët mendojnë se nuk ka gjë më të lehtë sesa të merresh me fatin e popullit tënd. Politikanë të cilët na sollën në situatën në të cilën ndodhemi: që shumë nga këto parti i afrohet fundi i turpshëm dhe do të përfundojnë si lehona që i lindin “kopilët” e vet, ata të cilët kur ditën kur partia nuk do ua përmbush ambicinet e tyre individuale, janë në gjendje ta shkatërrojnë atë.

Pra, kështu do të jetë, përderisa politika shqiptare do të udhëhiqet me patriotë të rrejshëm, pse jo, edhe për derisa kultura politike dhe mentaliteti i votuesve të papërgjegjshëm gjen vend në vetveten e tyre! Po pra, politika dhe “tallava” muzika shqiptare janë veprimtari që me shpejtësi të bëjnë të pasur e të famshëm. Dhe përderisa tallava këngëtarët nuk dëmtojnë askënd, por ua shtojnë humorin dëgjuesve të vet, “tallava” politikanët e marrin në qafë popullin dhe votuesit. Ata madje i shkatërrojnë edhe partitë që i kanë themeluar, vetëm pse ato më nuk mund t'ua realizojnë ambicinet karrieriste dhe interesat personale. Me çka shihet qartë pse partitë shqiptare themelohen lehtë, por edhe lehtë copëtohen e shkatërrohen: Sepse themeluesit dhe oligarkia e tyre partiake nuk kanë për qëllim realizimin e asaj që ua premtojnë votuesve, por atë që ua thotë xhepi dhe atë që ua thonë patronët.

Roli i dhe kontributi i mjekëve në shoqëri

Humanistët më të zë të njerëzimit ndër sh



Toni Ujkaj

Roli dhe kontributi që ka mjeku në shoqëri, jo vetëm sot, por ndër vite, dhe në tërësi i personelit mjekësor, zë vend jashtëzakonisht të rëndësishëm në shoqëri.

Imagjinojeni se si do të ishte bota vetëm për një ditë pa mjekët, pa personelin mjekësor e pa institucione të shëndetësisë. Paramendojeni sa të sëmurë do të vdisnin, sa të tjerë me probleme kronike shëndetësore dhe të sëmurë të çastit, do të mbesnin në mëshirën e Zotit, dhe jeta e tyre ndoshta do të mbaronte për disa sekonda, apo orë.

Duke e imagjinuar një skenar të tillë i cili do të kishte pasoja kolosale, lind një arsye logjike, morale e njerëzore që të ndalemi për një çast dhe të reflektojmë thellë, e të mendojmë se sa i çmuar, i domosdoshëm dhe jetik, është roli i mjekut në shoqërinë njerëzore.

Mjekët duhen konsideruar dhe personifikuar si individë me virtytet më larta humane dhe njerëzore, duke u nisur nga lloji i veprimtarisë që ushtrojnë në shoqëri.

Kontributi i tyre në shoqëri, nuk mund të matet apo krahasohet me asnjë profesion tjetër në morinë e profesioneve që ka shoqëria njerëzore. Mjekët nuk duhet shikuar si dikë që kryen punën sepse për të paguhet, merr rrogë. Jo, profesioni i mjekut duhet parë në një këndvështrim shumë më të gjerë se kaq. Fusha e mjekësisë nuk duhet shikuar asnjëherë vetëm si një profesion, por është shumë më tepër se kaq. Mjekë-

sia është një mision human, fisnik e njerëzor që tejkalon çdo profesion tjetër në shoqëri për nga përgjegjësia e kompetenca që ka, por edhe nga rëndësia e pazëvendësueshme me asnjë fushë tjetër të shoqërisë.

Njeriu, që foshnjë, por edhe më vonë në të gjitha fazat e jetës, ka nevojë permanente dhe të pashmangshme për mjekët, për institucionet shëndetësore dhe në tërësi për personelin mjekësor.

Një dhimbje, kudo dhe sado e vogël ta ketë në trup, ai menjëherë ndihmën e parë dhe personi i parë që i bie ndërmend ta kontaktojë dhe vizitojë, është mjeku- shtëpia e shëndetit apo spitali. Dhe menjëherë pas

marrjes së ndihmës nga mjeku dhe me të lehtësuar të dhimbjeve, individi ndjehet sikur u lind për së dyti, pra, është mjeku ai i cili bënë të ndjehemi më mirë, më pozitiv dhe i cili na rikthen shpresat për të vazhduar jetën e mëtejshme.

Dhe kur bëjmë më mirë apo shërohemi plotësisht, qoftë nga sëmundje të ndryshme, qoftë nga aksidente apo fatkeqësi të tjera që janë pjesë e paevitueshme e jetës së gjithsecilit, ndalemi dhe reflektojmë. E shohim figurën e mjekut si diçka hyjnore, pas Zotit. Pse si diçka hyjnore? Sepse është pikërisht mjeku ai i cili na gjendet më afër se askush tjetër, për çdo trazim dhe shqetësim që mund të



Shëmb Mjekuj

kemi në çdo periudhë të jetës, deri në vdekje.

Pra mjekët duhen konsideruar dhe vlerësuar si heronj të vërtetë për gjithë kontributin e tyre të paçmuar që i japin shoqërisë njerëzore nga dita në ditë, nga muaji në muaj e nga viti në vit. Kontributi i tyre sublim, duhet çmuar dhe vlerësuar nga e gjithë shoqëria, që nga njerëzit e zakonshëm e deri tek institucionet qeveritare dhe joqeveritare.

Ndonëse shpeshherë veprimtaria aq humane e mjekut dhe në tërësi e personalit mjekësor, nuk është e vlerësuar sa duhet, është koha e vetëdijesimit dhe nderimit në çdo aspekt ndaj punës dhe misionit të mje-

kut. Ata duhet çmuar dhe vlerësuar me të gjitha mundësitë e mundshme, dhe të tregohet dashuri, kujdes dhe respekt për të gjithë mantelbardhët nga e gjithë shoqëria. Po ashtu ndaj tyre, duhet treguar edhe mbështetje materiale dhe financiare nga institucionet relevante, për përmirësimin dhe avancimin e statusit të tyre në shoqëri, për një status më të mire që ata do të duhej ta gëzonin në shoqëri, si “shpëtimtarë” të njerëzimit.

Mund të thuhet se mjekët ende nuk gëzojnë vëmendjen e merituar nga shoqëria apo nga institucionet, për veprimtarinë e tyre që kryejnë. Vlerësim ndaj punës së mjekut nuk mund të jetë vetëm një falënderim dhe mbështetje morale. Atyre u nevojitet edhe mbështetje financiare për përmirësimin e kushteve në vendet e punës dhe në tërësi për një mirëqenie më të favorshme, ndër të cilat do të hynte padiskutim edhe paga më e kënaqshme për llojin e punës që kryejnë në shoqëri.

Nisur nga një sërë arsyesh të pafundme, se pse duhet nderuar dhe vlerësuar pa asnjë rezervë kontribu-

ti i mjekut në shoqëri, marr shkas të konkludoj se ata janë njerëzit që duhet ngritur në piedestalin më të lartë të nderimeve dhe vlerësimeve për misionin e tyre të shenjtë që ushtrojnë ndër shekuj.

Për të gjithë ata që nuk e kanë njohur sa duhet angazhimin, bamirësinë, mundin, sakrificën dhe atributet shumëdimensionale të mjekut në shoqëri, paten rastin që t'i njohin ato më së miri në kohën e pandemisë së koronavirusit (nga fundi i vitit 2019), gjatë një situatë dramatike e cila gjunjëzoi botën e njëkohësisht, mobilizoi gjithë personelin dhe institucionet mjekësore botërore në shërbim të njerëzimit. Veprimtaria e tyre humane dhe njerëzore nuk kishte orar të caktuar, por ndihma dhe nevoja e tyre i duhej më shumë se kurdoherë tjetër botës mbarë, në çdo orë të ditës dhe natës. Ata ishin kujdestarët më të mëdhenj të të prekurve nga kjo sëmundje, me një objektiv të qartë dhe të vetëm, atë të shpëtimit të jetës së njerëzve, edhe pse duke shpëtuar të tjerët e duke vënë në dispozicion të tyre të gjithë potencialin intelektual dhe teknik, shumë mjekë e humbën edhe jetën e vetë.

Nisur nga skenari më i trishtë që përjetoi njerëzimi që nga koha e gripit spanjoll (1918-1920), ne duhet të dimë të gjykojmë në mënyrën më të arsyeshme të mundshme ndaj figurës, rolit, rëndësisë, sakrificës, përpjekjes, këmbënguljes, kontributit të pareshtur dhe vetëflijimit që kanë dhënë mjekët në të gjitha etapat e zhvillimit të shoqërisë njerëzore.

Ne si individë, të gjithë së bashku, të cilitdo profesion qofshim, duhet të dimë t'i çmojmë dhe t' u japim mjekëve respektin më të thellë dhe mirënjohjen më të sinqertë për gjithçka që ata i japin shoqërisë njerëzore, në shpëtimin e jetëve, shërimin e të sëmurëve, në avancim e sistemit shëndetësor në shkallë globale, dhe për gjithë angazhimin e tyre konsistent dhe të palodhshëm në fushën e mjekësisë.

Prandaj, duhet thënë, nderim dhe lavdi të përjetshme ndaj gjithë mjekëve të përkushtuar të cilët jetën e vetë e vendosin në shërbim të humanizmit, e që Betimi i Hipokratit mbetet gjithnjë, udhërrëfyese i misionit të tyre për të shpëtuar jetë njerëzish.



Dr. Athanas Gegaj se Kastriotët ish racë e pastër ar



**Gjekë
Gjonaj**

Për Dr. Athanas Gegajn, shkruan Moikom Zeqo, Kastriotët ishin një racë e pastër arbërore, sepse kemi dëshminë e qartë të vetë Skënderbeut. Emri i tyre më i vjetër është Mazreku, i panjohur nga kronikanët e kohës, më pas u zëvendësua nga mbiemri Kastrioti. Për Gegajn familja e Kastriotëve mbiemrin e parë e ka marrë nga fshati Mazreku që ndodhet midis Shkodrës dhe Drivastit, në bregun e djathtë të Drinit, kurse mbiemri Kastrioti që mbijetoi në histori lidhet padyshim me lokalitetin e Kastrit në Mirditë, i cili ndodhet midis fshatrave të Dibrës, Minellës, Kashnjetit dhe Vigut. Kastriotët kanë zotëruar një pjesë të madhe të territoreve në verilindje të Shkodrës dhe të Lezhës dhe deri në Prizren. Në perëndim takoheshin me pronat e Dukagjinasve që përfshinin fushën e Zadrimës dhe lokalitetin e Fandit. Por nuk mund të përcaktohen me saktësi kufijtë që ndanin pronat e këtyre dy familjeve. Në kohën e fuqizimit të shtetit të Balshajve, Dukagjinasit dhe Kastriotët u shpronësuan nga pasuritë e tyre, por pas rrëzimit të Balshajve, Kastriotët i fituan sërish pronat.

Gjon Kastrioti konsiderohej si “Zot i Matit”

Gjon Kastrioti, i ati i Gjergj Kastriotit njihet si “Zot i Matit”. Ai zotëronte prona në rrethinat e Shkodrës dhe të Lezhës. Por, qyteti i famshëm i Kru-

jës nuk bënte pjesë në pronat e tij. Gjon Muzaka pohon se Kastriotët zotëronin Matin, por nuk pranon që qenë dhe zotër të dy Dibrave. Gjoni kishte disa kështjella si Petrelën, Stelushin dhe Zvedigradin në Dibrën e Sipërme. Gjon Kastrioti që i lidhur me Republikën e Venedikut, në 1413 atij iu dha titulli “i Qytetarit të Nderit”. Për të shpëtuar jetën dhe pasuritë e tij nga sulmet turke në 1417 Gjoni shpallet Vasal i Venedikut. Më pas Gjon Kastrioti i sprapsur nga forcat turke i dërgon djemtë e tij si peng në Adrianopojë. E njeh autoritetin e Sulltanit dhe e quan “miosignor”. Megjithëse i ka humbur shumicën e pronave Gjoni është akoma zot i një pjese të territorit të dikurshëm. Nga fundi i jetës Gjoni afrohet me Republikën e Raguzës. Vdiq më 1443. Pronat e tij u morën nga turqit dhe në Krujë u vendos Hasan Beu, ishte djali i Ajdin Beut dhe Elena Muzakës.

Për Athanas Gegajn gruaja e Gjon Kastriotit, Vojsava që “nga një familje me origjinë shqiptare”

Ata lindën 4 djem, Reposhin, Stanishën, Konstandinin dhe Gjergjin dhe pesë vajza të cilat u martuan të gjitha me zotër arbërorë, Marina me Stefanin Princin e Malit të Zi, Vllaica me Gjijn Muzakën, Angjelina me Vlash Aranitin, vëllain e Gjergj Aranitit, Angjela ose (Jella) me Pal Balshën dhe Mamica me Muzak Topinë. Gjergj Kastrioti ka lindur rreth viteve 1404-1405. Në vitin 1410 gjatë pushtimeve të Muratit II, Gjoni ka lënë peng

njërin prej djemve të tij, ndoshta Reposhin. Gjoni midis viteve 1421-1422, në emër të djemve i dhuroi Manastirit të Hilandarit në Athos dy fshatra. Athanas Gegaj e analizon kështu këtë fakt: “Ky veprim ka shtuar kureshtjen e historianëve, nëse Gjoni ishte katolik, ndërsa djemtë ishin kthyer në myslimanë, pse babai i tyre i dhuronte këto fshatra një manastiri ortodoks. Si mund të shpjegohet kjo? Së pari, bëhet fjalë për një akt të kryer para dhënies peng të djemve të Gjon Kastriotit. Pastaj, në qoftë se dihet me siguri që Reposhi dhe Gjergji janë kthyer në myslimanë, mund të dyshohet për të tjerët. Duke pasur parasysh fanatizmin e fesë në atë kohë, besohej se kthimi i tyre në fenë islame ka qenë i detyruar, sipas pikëpamjes së tyre, ai ishte një veprim oportunist, që i jepte Sulltanit siguri për besnikërinë e tyre. Për sa i përket dhuratës që iu bë Manastirit Ortodoks bëhet fjalë në fakt për këmbim pronash midis Gjonit dhe murgjve. Por, edhe mund të supozohet se ai ua ka bërë murgjve këtë dhuratë, për të cilën nuk është për t’u çuditur shumë, sepse kishte ortodoks midis njerëzve të tij”.

Si e mori Gjergj Kastrioti emrin Skënderbeg?

Historinë e rinisë së Skënderbeut Athanas Gegaj e përshkruan sipas traditës, që ai ka shkruar si peng, arriti të bëhej i preferuari i Sulltanit, ka hyrë në trupën e Jeniçerëve dhe ka marrë pjesë në disa betejat në Azinë e Vogël. Që kur u kthye turk atë

Gegaj pohon në një bërrore



e quajtën Iskender dhe meqë ishte me origjinë të lartë i shtuan titullin bej ose beg dhe prej këtej vjen emri Skënderbej ose Skënderbeg. Pas vdekjes së Gjonit më 1443 Sulltani vendos guvernator të Krujës Hasan Beun dhe i dha urdhër atij të pushtoheshin të gjitha fortesat e Kastriotëve që u morën pa rezistencë. Nëna e Skënderbeut me vajzën e vogël Mamicën u fshehën në një vend të panjohur të Matit. Atje Vojsava vdiq para kthimit të të birit. Në vitin 1443 në betejën e Kunovicës pranë Nishit ushtrinë turke e drejtonin Karabegu, pashai i Rumelisë por dhe Skënderbeu. Skënderbeu i la pozicionet e tij dhe mbas shpartallimit të turqve, së bashku me të nipin dhe me 300 kalorës, mbasi i morën dhe kancelarit të sulltanit Urdhrin e falsifikuar që e emëronte zot të Krujës, u kthye në Krujë. Sapo u kthye botërisht Skënderbeu e quajti veten të krishterë, pastaj mori fortesën e Petrelës dhe të Spellushit dhe pak më vonë të Stefigradit. Ky moment historik është quajtur në mënyrë dyfishtë si “Çlirimi i Skënderbeut dhe çlirimi i Arbërisë”. Pikërisht tani fillon epoka e madhe dhe e pashembullt Skënderbejane.

Lidhjet mes familjeve të mëdha të Aranitëve dhe Kastriotëve

Dy familjet e mëdha Aranitët dhe Kastriotët i kanë pasur lidhjet shumë më të hershme. Ka gjasa që Gjergj Araniti edhe Gjon Kastrioti edhe më pas Gjergji ishin njohur në rrethanat kur sundimi otoman përdorte

institucionin e pengut, si një garanci besnikërie. Kështu Gjergj Araniti dihet se ka qenë në oborrin e sulltanit për ca kohë. Rreth viti 1427 u largua dhe erdhi në Arbëri. Në vitin 1432 Andrea Topia bëri një sulm duke i shkaktuar humbje të mëdha turqve. Është pikërisht Andrea Topia ai, të cilit i takon merita e parë e shkaktërrimit të një ushtrie turke. Sipas Gegajt Topiajt patën dhe një degë të familjes në jug, të vetëquajtur Aranit. Në të vërtetë familja Aranitase është shumë e vjetër. Ajo përmendet që në kohën e Perandorit të Bizantit Bazilit II, kur një strateg i shquar David Araniti spikati në një betejë në perandorinë bullgare në 1016. Në shekullin XIII familja e Aranitëve u lidh në një martesë me Komnenët dhe kështu familja mbiquhej Aranit Komneni. Por vetëm në shekullin XIV mund të përcaktohet më me siguri historia e kësaj familjeje.

Fitoret e lavdishme të Skënderbeut

Athanas Gegaj i kushton kujdes luftërave që bën Skënderbeu, sidomos ndaj një kundërshtari të rrezikshëm dhe një ushtaraku të aftë në krye të forcave turke siç është Ballaban Pasha. Sulltan Mehmeti II duke dashur të hakmerrej dhe i etur që ta shtrinte pushtetin perandorak të tij në Evropë deri në kufijtë e Adriatikut, vendosi që të vijë vetë dhe të drejtojë luftimet kundër Skënderbeut. Në Pranverën e vitit 1466 Sulltan Mehmeti II me një ushtri shumë të madhe erdhi në trojet arbërore, duke pasur si

synim pushtimin e Krujës. Ai ndërtoi Kështjellën e Valmit, ose të Skampas duke e mbigjuajtur Elbasan për ta pasur si një qendër kryesore strategjike të përparimit dhe të vendosjes së kohëzgjatjes të sundimit osman edhe në Ballkan. Por, ekspedita e Sulltan Mehmetit II nuk e mori Krujën. Edhe këtë herë Skënderbeu doli fitimtar. Në muajin dhjetor 1466 Skënderbeu erdhi në Romë ku i bënë një pritje të jashtëzakonshme dhe te shkëlqyer. Skënderbeu e ndërmori këtë udhëtim në Itali në Romë për shkak se ndihmat që ishin dhënë nuk mjaftonin, duke shpresuar që nëpërmjet famës dhe prestigjit që kishte të kërkonte ndihma shumë herë më të mëdha. Gegaj nënvizon “Skënderbeu i veshur si ushtar i thjeshtë,, i shoqëruar nga një numër vogël kuajsh dhe nga një shpurë të pakët, i çuditi të gjithë me thjeshtësinë e madhe të tij . Ai u prit nga Papa, por mori prej Papës pak ndihma në të holla me pretekstin se ishte në gjendje të keqe financiare”. Nga Roma Skënderbeu shkoi në Napoli ku u prit nga Mbreti Ferdinand me mirënjohje dhe dashuri të veçantë. Pastaj Skënderbeu u rikthye në atdhe në muajin prill 1467 e mundi serish një ushtri turke, siç thotë Gegaj “Korri dafinat e fundit të karrierës së tij të lavdishme.” Sulltan Mehmeti i dytë zbriti për herë të dytë në trojet Arbërore në pranverën e vitit 1467. Ai e rrethoi sërish Krujën. Por dhe këtë herë nuk mundi ta merrte. Në 17 janar 1468 Gjergj Kastrioti vdiq dhe u varros në katedralen e Shën Nikollës”, përfundon Zeqo.



Fragmente nga ditari i një klleznori (2)

Ditët e tmerrit për inteligjencën e arsimit shqip në Ulqin

Është paradoks i llojit të vet fakti që “elita” në krye të Lidhjes Komuniste të kohës i dha të drejtë vetes që sipas qejfit të saj të vlerësojë situatën politike, të parashikojë gjendjen dhe të marrë vendime arbitrare. Kësisoj vepruan me ne mësimdhënësit në Ulqin, duke na dënuar politikisht si të padevotshëm për arsim dhe të padenjë për të dhënë mësim. Ishte e kotë të ankohesh, të kërkosh të argumentosh se je i pafajshëm, se nuk ke bërë kurrfarë gabimi. Na vunë në shënjestër dhe na etiketuan si nacionalistë, irredentistë, shovinistë, armiq të shtetit etj..



**Qazim
Rexha**

(vijon nga numri i kaluar)

Situata politike në vitet '80 të shekullit të kaluar dhe më pas bëri që të mos e gëzoj të drejtën e ushtrimit të pro-

fesionit tim si mësimdhënës, sepse dënimi politik nënkuptonte edhe përjashtimin nga puna. Kjo ndodhi pas ngjarjeve politike në Kosovë, ku shqiptarët u ngritën në demonstrata për të kërkuar të drejtat e mohuara politike dhe njerëzore. Si pasojë e kësaj situatë, mosbesimi ndaj shqiptarëve do të bartet edhe në Ulqin dhe në trevat tjera shqiptare në Malin e Zi. Është paradoks i llojit të vet fakti që “elita” në krye të Lidhjes Komuniste të kohës i dha të drejtë vetes që sipas qejfit të saj të vlerësojë situatën poli-

tike, të parashikojë gjendjen dhe të marrë vendime arbitrare. Kësisoj vepruan me ne mësimdhënësit në Ulqin, duke na dënuar politikisht si të padevotshëm për arsim dhe të padenjë për të dhënë mësim. Ishte e kotë të ankohesh, të kërkosh të argumentosh se je i pafajshëm, se nuk ke bërë kurrfarë gabimi. Na vunë në shënjestër dhe na etiketuan si nacionalistë, irredentistë, shovinistë, armiq të shtetit etj. Në përpjekjet e tyre për të bindur popullin se kishin të drejtë për dënimin tonë politik, inskenuan ngjarje të ndryshme

kundrejt nesh. Për më tepër, nuk ishin të kënaqur vetëm me largimin tonë nga puna, por me veprime të sajara gjenin kinse “fakte” edhe për burgosjen e disave prej nesh (Bajram Rexha, Mehmet Bardhi, Ibrahim Ceka). Me këto veprime donin t’i frikësonin shqiptarët, sidomos pjesën më përparimtare – inteligjencën shqiptare, që të largohen nga vendlindja dhe të shpërngulen nga trojet e veta kudoqoftë, vetëm jashtë Ulqinit. Në këtë qëllim të tyre ogurzi ia arritën deri diku qëllimit, sepse shumë të rinj nga Ulqini me rrethinë dhe trevat tjera shqiptare në Malin e Zi të sotëm emigruan rrugë pa rrugë, me shumë vuajtje e sakrifica, duke lëshuar vatrat e tyre të trashëguara brez pas brezi nga ballarët e tyre.

Mua dhe shokëve të mi të dënuar politikisht, të cilët na larguan nga puna, apo ata që fituan vërejtje për parapërrjashtim nga puna, na vinte keq për synimet ogurzeza të armiqve tanë. Punonjësit e sigurimit i thërrisnin në biseda shumë shqiptarë të paburra, por më shumë na lodhnin të tjerët të cilët i shërbenin si lakenj UDB-së me fraza të thata, kurse për malazezët nuk çuditeshim sepse e dinim çfarë mendonin për ne! Kuptohet, jo të gjithë.

E kemi ditur se Lidhja Komuniste, si organizatë politike që ka shënuar historinë e zhvillimit shoqëror të kohës, ishte nxitësja kryesore e këtyre ngjarjeve. Por nuk kemi mundur ta marrim me mend se vetëm me një shpallje se “Je armik i popullit!”, domethënë të paargumentuar dhe pa kurrfarë fajti të shpallësh armik i popullit dhe i shtetit. Pas shpalljes sonë si armiq, e pësonin edhe familjarët dhe të afërmit tanë. Për të na diskredituar publikisht si armiq të popullit, kudo në trevat shqiptare dhe në mediat e ndryshme trajtoheshim si armiq të shtetit, irredentistë etj.

Denoncimet politike kundër kuadrit arsimor shqiptar në Ulqin filluan me fjalimet ogurzeza të varrezat në Dushkakuq - fshati Pistull i Komunës së Ulqinit, të mbajtura para luftëtarëve në vitin 1981, në ditën e përkujtimit të të rënëve dhe të mbijetuarve gjatë Luftës së Dytë Botërore. Fjalimet kërcënuese të luftëtarëve Andrija Vojvodiq dhe Bllazho Vukoviq ishin sinjali i parë për atë që do të ndodhte më vonë – përndjekjen e mësim-

“

Në përpjekjet e tyre për të bindur popullin se kishin të drejtë për dënimin tonë politik, inskenuan ngjarje të ndryshme kundrejt nesh. Për më tepër, nuk ishin të kënaqur vetëm me largimin tonë nga puna, por me veprime të sajara gjenin kinse “fakte” edhe për burgosjen e disave prej nesh. Me këto veprime donin t’i frikësonin shqiptarët, sidomos pjesën më përparimtare – inteligjencën shqiptare, që të largohen nga vendlindja dhe të shpërngulen nga trojet e veta

dhënësve shqiptarë nga Ulqini dhe shqiptarëve të tjerë në Mal të Zi.

Pretekst për këtë u përdorën fjalimet e mbajtura nga mësimdhënësit shqiptarë në seminarin për arsimin shqip, të organizuar nga funksionarët republikanë për arsim dhe kulturë, në rend dite të të cilit ishte shkurtimi i orëve në klasat me mësim në gjuhën shqipe. Kërkonin që të zvogëlohej fondi i orëve në gjuhën shqipe të lëndëve të identitetit kombëtar, si Gjuhë Shqipe, Histori, Gjeografi, Art Muzikor etj. dhe në vend të tyre të vendosen orë nga lëndët që propagandonin patriotizmin socialist-komunist jugosllav. Me një fjalë, kërkonin të rritej fondi i orëve në gjuhën serbe të historisë dhe kulturës serbo-malazeze në dëm të asaj shqiptare. Kundrejt kësaj padrejtësie nuk mund të heshtnin në radhë të parë mësimdhënësit e këtyre lëndëve. Për pasojë, të gjithë ata që guxuan të flisnin dhe kundërshtuan këtë, u denoncuan dhe u dënuan me dënime të ndryshme politike. Kjo çështje u bë temë diskutimi në organin më të lartë politik komunal e pastaj kërkuan që për të, të diskutohet nëpër të gjitha institucionet politiko-shoqërore, arsimore etj. deri te bashkësitë vendore në nivel të komunës.

Atmosfera e acaruar politike, duke filluar në Kosovë dhe veprimet e sajara në Ulqin frikësuan masën duke bërë në tubime denoncime politike në tërësi. Pra, elementet negative në shoqërinë e atëhershme na shpallën fajtorë, armiq të shtetit, nacionalistë, irredentistë, na fyen dhe akuzuan me shpifje dhe fjalë të rënda. Në një atmosferë të tillë, na përjashtuan nga puna pa të drejtë që të punojmë në arsim.

Duke mos qenë fajtorë, dilnim dhe shëtisnim lirish në qytet. Mirëpo

edhe kjo u pengonte! Shumë udhëheqës politikë të kohës në Ulqin e kthenin kokën në anën tjetër kur takoheshim në rrugë, vetëm për të mos na parë. Të revoltuar nga fakti pse ne shëtisnim lirish, në një rast kryetari i Komunës së Ulqinit, M. M., iu drejtua të deleguarit republikan M. Sh. që t’u ndihmonin organeve të pushtetit në Ulqin. Ai iu përgjigj që të mos frikohen sepse tërë populli i vet në Ulqin i ka denoncuar si armiq nëpër të gjitha poret e veta politike, shoqërore etj.. Kur na dënuan, na braktisën pothuajse të gjithë të afërmit dhe të njohurit. Mbeta me familjen time të ngushtë. Çdokush kishte frikë të na vizitonte apo të na ndihmonte. Në këtë situatë, pa punë dhe pa të ardhura për jetë, vështirë të merrte kush në punë edhe për të bërë punë krahu.

Por në tërë këtë çmenduri, ka pasur edhe shembuj pozitivë. Sekretar i Komitetit të LK-së në Ulqin ishte Aleksandar – Aco Janinoviç, i cili ka treguar mençuri në vlerësimin e situatës politike në Ulqin. Duhet t’i jemi mirënjohës që ka ndaluar trazirat politike në përmasa masive kundër shqiptarëve dhe e ka ruajtur Ulqinin me shumë pjekuri e mençuri që të mos çohet në protesta apo demonstrata, me ç’gjë ka ruajtur traditat shumëvjeçare të marrëdhënieve të mira ndërnacionale dhe ndërfaqetare në Ulqin.

Për fund, iu lumtë të gjithë atyre që kundërshtuan diktaturën komuniste deri në vitin 1990.

Atë çka kam përjetuar unë, dikujt nuk do t’i përgjigjet ta them...! Mbetet punë e madhe, por e lavdishme, që gjeneratat e ardhshme – sot, nesër, pasnesër e në vijim të ndriçojnë atë që e kaluara dëshironte ta heshtë ose edhe më shumë!
(Fund)

Ali Llunji

Oazë e dijes dhe



Luljeta Avdiu-Cura

Në historikun e pedagogjisë kombëtare, shkolla tetëvjeçare e Katërkollës duhet të gjejë vendin meritore të saj. Kjo shkollë shqipe me pak ndërprerje gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore ka luajtur rolin e shumëfishtë të saj në mësimin e gjuhës amtare, në arsimimin e shtresave të gjera, në shkollimin e mëtutjeshëm të kuadrove, në ngritjen e vetëdijes kombëtare e shumë lëmi të tjera. Të gjitha këto janë arritur me punën e palodhshme dhe me përkushtimin e kuadrit arsimor, nën dre-

në hapësirat e Malit të Zi, që edhe ndoshta do të mund të radhitet si shkollë eksperimentale, një pjesë e mirë e mjeteve të konkretizimit është punuar nga dora e nxënësve. Aty ka funksionuar një sistem i papërshtuar pune. Paradite zhvillohej procesi i rregullt mësimor, ndërsa në orët e pasdites fillonte puna e aktiviteteve të lira.

Paradite kuadri arsimor dhe drejtori i tyre ishin me gardërobë në shkallë të lakmueshme, pasdite drejtori, duke marrë pjesë në punë fizike i ngjasonte një fermeri. Këtu nxënësit janë brumosur me shumë shkathtësi dhe kanë krijuar shprehi të rralla për punë. Në ato rrethana të ndërlikuara dhe mjaft të vështira në të cilat gjallëronte popullata shqiptare e Anamalit, kjo shkollë shërbente si një oazë e dijes dhe shpresë për ditë më të mira. Ajo ka gëzuar, në mos tjetër, edhe një përkrahje të fortë morale nga shtre-



Faqe nga libri i përshtypjeve.



jtimin e njeriut të urtë, pedagogjikisht shumë të ngritur, drejtorit shumëvjeçar z. Jonuz Divanoviçit (ose Divan-it). Në këtë shkollë, për mendimin tim, ndër shkollat më të mira shqipe

qenë specifik-kryesisht i specifikuar dhe i diplomuar në Shkollën Normale Shqipe të Gjakovës dhe të Prishtinës në shkolla të larta pedagogjike dhe në fakultete të kohës. Në mesin e këtij kuadri të vyer kemi shërbyer tre

sa të shquara të Kosovës si shkrimtarë, artistë, gazetarë dhe krijues nga sfera të ndryshme, gjatë vizitave që i bënin. Këtë e dokumentonin në librin e përshtypjeve duke thënë fjalë miradije për shkollën, nxënësit dhe kuadrin mësimor në përgjithësi dhe për punën vetëmohuese të drejtorisë në veçanti. Kuadri arsimor i shkollës tetëvjeçare të Katërkollës ka

anëtarë të familjes Llunji nga Ulqini dhe Tirana. Ishte motra ime, e ndjera Limone Llunji, bashkëshortja ime e lindur në Tiranë e rritur dhe e shkolluar në Gjakovë dhe në Prishtinë, Lum-nije Kastrati-Llunji dhe unë. Do të them disa fjalë, me pak nostalgji, për mësuessen e parë me diplomë, motrën time Limone Llunjin, që në martesë mbante mbiemrin Tarani. Ajo ka lindur në Ulqin më 28 Nëntor 1937 dhe ka vdekur në Gjakovë më 27 Prill 2010, ku shërbeu me nder deri në pensionim. Pas kryerjes së shtatëvjeçares në Ulqin në gjuhën shqipe, ajo vazh-

me e shpresës



don shkollimin e mesëm në Shkollën Normale Shqipe të Prishtinës në vitin shkollor 1953/57. Rrjedh nga një familje përparimtare, arsimdashëse dhe kombëtarisht shumë e përcaktuar. Nga gjiri i kësaj familjeje, dikur detarë, tregtarë e hoxhallarë, dolën kuadro të shkolluar, mësues, profesorë e doktorë medicinalë, inxhinierë të elektros dhe të ndërtimtarisë, gazetarë, publicistë etj.

Me të kryer Normalen Shqipe të Prishtinës, në vitin shkollor 1957/58, Limone Lllunji emërohet mësuese në shkollën tetëvjeçare të Katërkollës. Ishte mësuesja e parë shqiptare e

kësaj shkolle. Në moshë të re shërbeu shembull për sjellje korrekte dhe punë vetëmohuese, përbrenda një mjedisi rural që vuante nga prapambeturia dhe gjendja e rëndë sociale. U angazhua me tërë qenien në ngritjen e vetëdijes së filloristëve të saj, se vetëm libri dhe dituria do të jenë drita e jetës së tyre. Punoi me të gjitha klasat, dhe veç mësimit organizoi aktivitete të lira. Për punën arsimore, nga inspektorët arsimorë u vlerësua me notën më të lartë "Dallohet posaçërisht".

Punën pedagogjike pas pesë vjetëve shërbimi në Katërkollë, e vazhdoi në

Kosovë. U martua në Gjakovë dhe për disa dekada e vazhdoi punën arsimore-pedagogjike në një shkollë fillore të këtij qyteti.

Kam pasur fatin të jem mësimsdhënëse i disa lëndëve: Kimi, Biologji, Dituri Natyre e sipas nevojës edhe Edukatë Fizike, pranë shkollës tetëvjeçare në Katërkollë. Këtu e kam filluar karrierën e shkurtër në fushën e arsimit dhe të edukimit të nxënësve të cilën do ta vazhdoja në shkollën tetëvjeçare (tani) "Gjergj Fishta" dhe në gjimnazin "Sami Frashëri" të Prishtinës.

Sa isha mësimsdhënëse në Katërkollë, qëllim parësor kisha që të nxënësit të kultivoja dashurinë ndaj dijes dhe ngritjes së botëkuptimeve të shëndosha. Shkolla nuk kishte kabinete përkatëse, por me ato pak mjete arrinim ta bënim mësimin sa më interesant dhe kuptimplotë. Ka ekzistuar "Këndi i gjallë", angazhoja nxënësit të sillnin bimë dhe shtazë që i zinin në mjediset e fshatrave të tyre. Bashkëpunimi me kolegë-mësimsdhënëse ka qenë në nivel; përpiqeshim, aq sa lejonin rrethanat e kohës ta ndihmonim njëri tjetrin. Nxënësit ishin shumë të dëgjueshëm dhe të disiplinuar. Rrallë ndonjëri për arsye madhore vinte i papërgatitur. Gjatë mësimit ishin të qetë dhe kërkonin sqarime për ndonjë çështje të pakuptueshme. Prindërit e nxënësve, edhe pse rrallë vinin, meqë ishin të angazhuar në punë të rënda, interesoheshin për suksesin dhe mbarëvajtjen e fëmijëve të tyre. Kur ndaheshin nga unë thoshin-"Juve jua kemi falë këta fëmijë. Ju t'i mësoni që nesër të bëhen të mirë për ne dhe për këtë vend". Dhe vërtet, shumë nxënës të asaj gjenerate që unë i mësova u bënë kuadro të dalluar në profesionet që kishin zgjedhur. Për mua puna e mësimsdhënësit në këtë shkollë mbetet një kujtim nga dita kur i shtronim detyrë dhe obligim vetes ta ngrinim më lart cilësinë në shkollim dhe edukimin e shëndoshë të filizave të rinj.

Botime të reja, Valbona Bajri – “Jetojmë në një kohë”, poezi, Ulqin 2024

Në çfarë kohe jetojmë?



Teksti dhe fotografitë:

**Gazmend
Çitaku**

Besoj se secili prej nesh një herë në jetë ka pasur rastin që dikush ta këshillojë që ta jetojë jetën ashtu siç është, ashtu si i vjen dhe në kohën e tashme. Duke shkruar këto rreshta më shkojnë nëpër mendje librat psikologjik motivues, të tipit Echard Tolle, me temën e të jetuarit në kohën e tanishme. Kështu fillova të ndjehem edhe kur fillova ta lexoj librin më të ri që doli nga shtypi me titull “Jetojmë në një kohë”.

Kemi të bëjmë me librin me poezi të autores Valbona Bajri, e cila para publikut vjen e çiltër, ballëhapur dhe plot mesazhe. Të jetosh në kohën e tanishme nuk do të thotë se nuk ke pasur të kaluar apo nuk bën plane për të ardhmen, kështu që Valbona, nuk ka frikë të japë këshilla sepse ajo e di se “... frika jeton atje përtej detit” (faqe 28) andaj edhe merr guximin e të flasë sepse “Fjala i takon kohës dhe heshtja përjetësisë” (faqe 25). Të jetosh duke “ëndërruar” për të kaluarën apo të ardhmen do të thotë se ju në të vërtetë jetoni vetëm në mendjen dhe në imagjinatën tuaj. Kësisoj autorja dëshiron të diskutojë, debatojë, shkëmbejë mendime. Ajo kërkon përgjigje nga lexuesi për çështje të ndryshme “Si ta mundim

padrejtësinë?” për shembull apo “A ekziston e përkryera?”. Duke hapur debat me pyetjen se “kush jemi ne?” tërheq vëmendjen në “të pasur që nuk ngopen apo të varfër që qajnë në udhët e gjata...” (faqe 15).

Gjuha është formati bazë i komunikimit mes njerëzve. Përmes gjuhës transmetohen informacione, ndjenja, kulturë kurse Valbona me të njëjtën mënyrë porosit “edukata fillon nga gjuha e komunikimit, sepse është gjuha ajo e cila na bën të mundur raportin tonë...” (faqe 13).

Fëmijët zënë vendin më të rëndësishëm në jetën e çdo njeriu. Ata jo vetëm se janë projeksioni ynë për të ardhmen por pafajësia e tyre bën që ata shumë mirë dallojnë dhe bashkëpunojnë me ata që u shprehin respekt. Valbona si mësimdhënëse që është këto ndjenja i përjeton çdo ditë. Merr ngrohtësinë e nxënësve të vet, por gjithashtu edhe ajo tek ata transmeton dijen dhe edukatën, duke i përgatitur për jetë. Fëmijët me pafajësinë e tyre si engjëj që janë, jetojnë “Mes tokës dhe diellit”. Në tokë me prindër, shoqëri, mësimdhënës dhe mes diellit me ngrohtësi, dashuri, ëndrra dhe fantazi. Autorja fëmijët i konsideron “Lule të gjalla të tokës” dhe “... mesazhe të gjalla të jetës” (faqe 24) dhe pafajësinë e tyre e barazon me butësinë e zogut:

“Eh... moj dëshirë e bukur e fëmijës, Bëhu realitet që zogu sërish të jetë i lirë

E ti o diell i ngrohtë bëj një mirësi...”

Ajo këshillon prindërit që të flasin sa më shumë me fëmijë sepse jetojmë

në një kohë të vështirë. Jetojmë në një kohë ku bota ka zbritur në pëllëmbë të dorës. Ku realja e fantazia janë mbërthyer në njëra tjetrën, saqë është shumë vështirë të dallohen. “Asgjë nuk është e pamundur nëse ne duam ... të ulemi dhe të flasim me këta margaritarë të vegjël, me këta fëmijë që e duan jetën...”

Kujtdo që i bie në dorë ky libër e këshilloj që të ndajë kohën dhe ta lexojë. Të marrë nektarin që ofron autorja e librit dhe ta shijojë melodiozitetin poetik.

Ky libër prej 94 faqesh, brenda kopertinave ofron një vister prej gjashtëdhjetë poezish dhe dhjetë skicash. Botohet me mbështetjen e Fondit për Mbrojtjen dhe Realizimin e të Drejtave të Pakicave i Malit të Zi. Redaktore e librit është Lumnije Metanoviq. Lektor Nail Bajri, redaktura teknike i nënshkruhet Gazmend Çitakut dhe është shtypur në shtypshkronjën Barllloviq.

Valbona Bajri u lind më 14.06.1986 në fshatin Çapraj – Ana e malit. Më krijimtari letrare u mor si nxënëse dhe studente. Kontribuoi me punimet e saj në prozë e poezi në revistat e shkollës “Shkëndijat” dhe “Fillimet”. Si gjimnaziste botoi përmbledhjen më poezi “Dy sy”, në vitin 2015 përmbledhjen më poezi “Fol më gjuhën e zemrës”. Në vitin 2020 botoi përmbledhjen më poezi “Diell pranveror” dhe në vitin 2023 përmbledhjen më poezi “Në Horizont”. Mbaroi studimet në degën Gjuhë Shqipe e Letërsi në Universitetin “Luigj Gurakuqi në Shkodër. Ky është libri i saj i pestë.



Qendra Ditore për Fëmijë dhe të Rinj me Pengesa dhe Vështirësi në Zhvillim "Sirena" organizoi

Të bashkëjetosh me dhimbjen e një fëmije me autizëm

Simpoziumi është organizuar në muajin prill që është muaji kombëtar i ndërgjegjësimit mbi autizmin. Mbi rëndësinë e përfshirjes së prindërve në procesin e rehabilitimit, që ishte temë kryesore e këtij simpoziumi, kanë ligjëruar logopedët Dr. Bojan Radiq nga Bosnja e Hercegovina dhe Msc. Ardita Zejnullahu nga Kosova

Ulqin – Qendra Ditore për Fëmijë dhe të Rinj me Pengesa dhe Vështirësi në Zhvillim "Sirena" organizoi të shtunën (13 prill 2024) në Ulqin simpoziumin e dytë mbi autizmin.

Në fjalën përshëndetëse në emër të organizatorit, drejtoresha e Qendrës Ditore "Sirena", Salije Meqikukiq, ka thënë se jemi sot këtu për të shënuar muajin e ndërgjegjësimit për autizmin, i cili në një mënyrë apo në një tjetër na simbolizon të gjithë neve që jemi këtu dhe jo vetëm.

Duke iu drejtuar të pranishmëve, ajo ka dhënë një mesazh për fëmijët me autizëm dhe familjarët e tyre.

"Ju dëshiroj një jetë të lehtë në komunitet, dashuri të ndërsjellë, sepse po aq sa ju për neve, edhe ne kemi nevojë për ju. Ndërsa për ju prindër të dashur, i përulëm forcës dhe kurajës suaj", është shprehur ajo.

Sekretari i shtetit në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Dr. Agron Ibrahim, ka folur për reformën e sistemit të mbrojtjes sociale dhe të fëmijëve, duke nënvizuar se ajo është

e orientuar në krijimin e një spektri të gjerë të shërbimeve parandaluese dhe opsioneve të përkujdesjes, si alternativa të institucionalizimit të fëmijëve me pengesa dhe vështirësi në zhvillim, përkatësisht fëmijëve me autizëm.

"Njëra prej shërbimeve shumë të rëndësishme të orientuara në pengimin e ndarjes së familjes dhe integrimin në komunitet në bazë të parimit të mundësive të barabarabarta dhe në përputhje me aftësitë e fëmijëve, është qëndrimi ditor, përkatësisht shërbimi i qëndrimit ditor i cili ofrohet në kuadër të qendrave ditore", ka theksuar ai.

Ibrahimi ka thënë se shërbimi i qëndrimit ditor të fëmijëve ofrohet në njëzet komuna në Mal të Zi dhe se Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale kontribuon financiarisht në këtë shërbim duke paguar shpenzimet e shfrytëzuesit.

Ai ka thënë se Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale do të përpiqet të përshpejtojë reformën e sistemit

të mbrojtjes sociale dhe të fëmijëve në përputhje me rekomandimet e Komitetit të OKB-së për të drejtat e fëmijëve dhe standardet ndërkombëtare.

Logopedja Anita Mariq, këshilltare për mësimin inkluziv në Entin për Shkollim, ka folur për sfidat në punën me fëmijët me autizëm.

Ajo ka vënë në dukje rëndësinë e përfshirjes së fëmijëve me nevoja të posaçme në sistemin e arsimit.

"Në vitin 1999, sistemi i arsimit (në Mal të Zi) e ka njohur nevojën që fëmijët me pengesa në zhvillim duhet të ndjekin shkollat e rregullta nëpërmjet inkluzionit, përkatësisht duke përfshirë modelin shoqëror përkundrejt atij mjekësor", ka theksuar Mariq.

Sipas saj, reagimi i shpejtë dhe në kohë ka shumë rëndësi në trajtimin e fëmijëve me autizëm.

Mariq ka thënë se premisa që fëmija me autizëm është i sëmurë është e gabuar, sepse autizmi është një gjendje ku fëmijës i nevojitet përkrahja jonë.

Në Ulqin simpoziumin e dytë mbi autizmin



“Për këtë arsye sugjerojmë modelin social para atij mjekësor e kjo do të thotë se të gjithë jemi përgjegjës njëjtë dhe se të gjithë duhet të përfshihemi në procesin e mbështetjes së fëmijëve tanë, pa marrë parasysh llojin e pengesës dhe pa marrë parasysh faktin se për kë kanë më tepër nevojë”, është shprehur ajo.

Mbi përvojat e tyre me autizmin kanë folur Blerina Shehu – Lala nga Tirana, nënë e një djali 20-vjeçar me autizëm, dhe Melinda Zaganjor nga Ulqini, nënë e një vajze 5-vjeçare me autizëm.

“Unë fjalën autizëm e mësova nga tim bir. Fëmijëria dhe adoleshënca e hershme e tij kaloi nga terapia në terapi. Pra, ka mbi njëzet vjet që përqipem të shpëtoj tim bir sadopak nga ky i mallkuar i quajtur autizëm”, ka theksuar Blerina Shehu – Lala, me profesion mësuese e gjuhës shqipe dhe letërsisë, njëherazi drejtoreshë

gjimnazi në Tiranë.

Ajo ka thënë se me gjithçka çfarë ka bërë deri më sot, nuk pretendon se ka fituar mbi autizmin e djalit të saj.

“Por me modesti e them që kam arritur ta shmangë tim bir nga rruga e sigurt e mbylljes së autizmit për aq kohë sa im bir është i pavarur në 50-70 për qind të nevojave të tij personale”, ka thënë Shehu – Lala, duke vijuar se vetëm ata që janë të lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me autizmin e dinë “se çfarë do të thotë të bashkëjetosh me dhimbjen e një fëmije me autizëm”.

Melinda Zaganjor, nënë e një vajze pesë vjeçe me autizëm, ka thënë se për çdo ditë mëson diçka të re nga vajza e saj.

Për autizmin, simptomat, trajtimin e tij, funksionimin e qendrave ditore etj. kanë folur edhe mjekja pediatre Dr. Vlora Duraku - Kurti, drejtoresha e Qendrës për Punës Sociale – Tivar,

Kërkesë që në komisionin për autizëm të ketë kuadro shqiptare

Organizatorja e simpoziumit të parë mbi autizmin në vitin 2018 në Ulqin, Dr. Zylfije Gjoni Duraku, ka treguar se një ide e tillë i ka lindur gjatë punës së saj si gjinekologe, duke dëgjuar vuajtjet e mëdha të nënave për fëmijët e tyre të prekur me autizëm.

Ajo ka kërkuar nga institucionet përgjegjëse shtetërore që në Komisionin për vlerësimin dhe diagnostifikimin e fëmijëve me autizëm, i cili ekziston në Podgoricë, të punësohen kuadro shqiptare – logopedë, psikologë, pediatër etj. për vlerësimin e fëmijëve shqiptarë me autizëm, pasi barrierat gjuhësore nuk e mundësojnë një gjë të tillë. Në rast se një gjë e tillë nuk mund të realizohet, Dr. Duraku ka propozuar që fëmijët me autizëm të diagnostikohen në Tiranë dhe Fondi i Shëndetësisë i Malit të Zi të rimbursojë shpenzimet e diagnostikimit.

“Presim mirëkuptim nga institucionet përkatëse për të mos undier të diskriminuar fëmijët dhe familjet e tyre pasi shpenzimet janë të mëdha dhe vështirësitë të papërbalueshme”, është shprehur ajo.

Biljana Pajoviq, drejtori i Qendrës Ditore në Cetinë, Bozhidar Drecun, sociologia Fatjona Geci, drejtoreshë e Qendrës së Autizmit “Fluturo për jetën” – Tetovë, Enkeleida Mataj, drejtoreshë e Shkollës speciale “3 Dhjetori” – Shkodër dhe Elona Hoxha - Gjika, menaxhere e Qendrës “Lumturo dhimbjen” – Tiranë.


Ndërkaq mbi rëndësinë e përfshirjes së prindërve në procesin e rehabilitimit, që ishte temë e simpoziumit të dytë mbi autizmin, kanë ligjëruar logopedët Dr. Bojan Radiq nga Bosnja e Hercegovina dhe Msc. Ardita Zejnullahu nga Kosova.

Simpoziumi është organizuar në muajin prill që është muaji kombëtar i ndërgjegjësimit mbi autizmin.

i. b.

Recension mbi tekstin shkollor “Gjithëpërfshirja në Edukimin fizik, në lojërat dhe sportet për nxënës me aftësi të kufizuara”

Tekst gjithëpërfshirës mësimor në Edukimin Fizik për nxënës me aftësi të kufizuara



**Shaban
Hasangjekaj**

Në vitin 2023, doli nga shtypi teksti shkollor “Gjithëpërfshirja në edukimin fizik, në lojërat dhe sportet për nxënës me aftësi të kufizuara” të autorit Ahmet Mahmutaj, ekspert në edukimin e personave me nevoja të veçanta, profesor shumëvjeçar i edukimit fizik dhe drejtor i Shkollës Speciale - Qendrës Burimore “Xheladin Deda” në Pejë, udhëheqës i shumë detyrave në Divizionin për sport në Komunën e Pejës, prof. asistent në Fakultetin e Edukimit në Prishtinë e Gjilan, këshilltar për punësim në HANDIKOS, trajner i ekipit kombëtar të futbollit për të verbër dhe anëtar i Bordit të KPK, si dhe autor e bashkautor në disa botime lidhur me personat me aftësi të kufizuara dhe gjithëpërfshirjen në arsim.

Tekstin mësimor në fjalë e botoi Komiteti Paralimpik i Kosovës, botimi i të cilit është bërë i mundur me mbështetje financiare nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës. Recensues të tekstit janë: Prof. dr. Naser Zabeli

dhe Prof. dr. Bujar Turjaka, Redaktor shkencor dhe lektotor: Enver Ulaj, Ballina: Ariana Mikullovc, Skenat dhe fotografitë: Panoti Design, Pejë, U shtyp në Shtypshkronjën “Dukagjini” në Pejë dhe përbëhet prej 286 faqesh.

Autori Ahmet Mahmutaj parathënieën e librit të vet e fillon me të dhënë se pas luftës së fundit në Kosovë, kushtet dhe rrethanat ndryshuan dukshëm, ndryshime këto që ndikuan edhe në fushën e arsimit. Fillimi i reformave në të gjitha nivelet e arsimit solli edhe nocione dhe koncepte të reja në trajtimin e arsimit special. Si mësimdhënës në ish-Shkollën Speciale në Pejë, autori Mahmutaj e ka kuptuar se veçimi i një pjese të nxënësve në shkolla speciale kishte efekte negative në jetën e tyre të mëtejme, por edhe të shoqërisë në përgjithësi. Procesi i transformimit nga sistemi i segreguar në atë gjithëpërfshirës, filloi pikërisht në këtë shkollë speciale tash e shndërruar në qendër burimore.

Si mësimdhënës i edukimit fizik, si trajner, si ligjërues i programit të FS-DEK dhe MASHT “Drejt një shkolle inkluzive për të gjithë”, apo si mësimdhënës udhëtues, autori Mahmutaj ka hulumtuar nëpër shumë shkolla në Kosovë dhe është ndeshur me qëndrime të ndryshme rreth gjithëpërfshirjes. Ka kuptuar se qëndrimet më refuzuese ndaj gjithëpërfshirjes vijnë

nga fakti se mësimdhënësit e edukatës fizike në shkollat e rregullta nuk kanë njohuri të duhura në fushën e gjithëpërfshirjes së nxënësve me aftësi të kufizuara. Shumica e këtyre mësimdhënësve nuk kanë pasur fare kohë për të bashkëpunuar me ndonjë mësimdhënës udhëtues apo ekspertë të edukimit special. Përveç kësaj, veçanërisht në shkollat fillore dhe të mesme numri i nxënësve në klasa është i madh dhe mësimdhënësit e edukatës fizike ndjehen të mbingarkuar me marrjen e përgjegjësive shtesë gjatë orarit të tyre të punës. Autori Mahmutaj ka pasur rast të takojë mësimdhënës të edukatës fizike, të cilëve u mjaftonte që një nxënës me aftësi të kufizuara të posedonte një vërtetim të mjekut, që ai të jetë i liruar nga orët e edukatës fizike për gjithë vitin. Por, pas disa këshillave se si mund të përfshihet një nxënës me aftësi të kufizuara në një orë të edukimit fizik, me pak modifikime të pajisjeve, rregullave apo mjedisit, mësimdhënësit ndjeheshin kuriozë, kreativë dhe shumë të motivuar për përfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuara në orët e tyre. Këtu nisi edhe ideja për shkrimin e këtij libri, shprehet autori Ahmet Mahmutaj.


Teksti shkollor “Gjithëpërfshirja në Edukimin Fizik, lojërat dhe sportet 1 për nxënës me aftësi të kufizuara”, është një libër me udhëzime praktike për përfshirjen e nxënësve me aftë-

nxënës me aftësi të kufizuara” të autorit Ahmet Mahmutaj (1)

irës imin me

si të kufizuara në edukimin e përgjithshëm fizik i ilustruar, demonstruar dhe konkretizuar me një vistër fotografish, foto-portretesh, figurash, skicash, tabelash, grafikonesh e vizatimesh të tjera në teknikën bardhë zi. Libri në fjalë u dedikohet mësimeve të edukatës fizike në Qendrat Burimore dhe shkollat e rregullta, studentëve të Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit, studentëve të Fakultetit të Edukimit, edukatorëve apo prindërve, të cilët mund të gjejnë lehtë udhëzimet për përfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuara. Ndërsa trajnerët dhe sportistët e parasporteve dhe sporteve paralimpike do të gjejnë rregullat bazë të lojërave dhe sporteve, si dhe metoda të mësimit të teknikave të tyre. Autori Mahmutaj thekson se libri është shkruar në bazë të një përvojë praktike shumëvjeçare të punës me nxënës dhe sportistë me aftësi të kufizuara. Ka shfrytëzuar burime dhe materiale teorike bashkëkohore nga kjo fushë nga vende me sisteme të avancuara të arsimit gjithëpërfshirës në botë.

(Vijon)



GJITHËPËRFSHIRJA NË EDUKIMIN FIZIK

lojërat dhe sportet për nxënës me aftësi të kufizuara

AHMET MAHMUTAJ

Ymer Halil Kuka, 1942- 2024

Vullnetar i Batalionit Atlantiku, ushtar lirisë së Kosovës



**Binak
Ulaj**

Pasi i ishte dhënë lamtumira e fundit dhe ishte varrosur me nderime të veçanta si luftëtar i lirisë në Nju Jork, më 24 mars 2024, shokët e kamotshëm, Meriman Braha, Zymer Neziri dhe Binak Ulaj, së bashku me Shoqatën e të Burgosurve Politike dhe Shoqërinë Lëvizja, më 6 prill 2024, në Prishtinë, organizuan pritje për ngushëllime për ndarjen nga jeta të ushtarit të UÇK-së, pjesëtar i Batalionit Atlantiku, Ymer Halil Kuka. Djali i Ymerit, Arbeni, vëllai, Mustafa dhe reja Luljeta, që kishin ardhur apostafat nga SHBA-ja dhe familjarët në vendlindje, do të ndajnë dhembjen me bashkëluftëtarë, veteranë të UÇK-së, zyrtarë të institucioneve shtetërore, shokë e miq që vinin për ngushëllime.

Ymeri ka lindur më 10 korrik të vitit 1942, në fshatin Vuthaj të Plavës e Gucisë, mu pranë kufirit që e ndante dhe vazhdon ta ndajë trupin e atdheut tonë. Posta e ushtrisë kufitare dhe ajo e milicisë jugosllave, të ngritura menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, që ishin vetëm disa dhjetëra metra larg shtëpisë së prindërve të tij, pa e hetuar do të nguliten në kujtesën e Ymerit të



vogël si godina që mbillnin frikë e pasiguri. Kjo ndjenjë frike do të reflektohet tek ai shumë vjet më vonë.

Ymeri do të rritet e burrërohet me rrëfimet për krimet e represionin e organeve shtetërore mbi popullsinë shqiptare, të cilat do t'i përjetojë edhe vetë që në moshë mitare. Në vitin 1956, në Plavë e Guci, si gjithandej në Mal të Zi, do të mbyllet shkollat shqipe. Ymeri, si dhe nxënësit tjerë shqiptarë, do të detyrohet t'i vijojë mësimet në gjuhën serbe, por shumë nga nxënësit e gjeneratës së tij dhe të gjeneratave pasuese, do ta braktisin shkollën njëherë e përgjithmonë dhe marrin botën në sy. Në kushte të tilla ku shteti jugosllav ndalonte shkollimin në gjuhë amtare e, me këtë, edhe përparimin e të rinjve shqiptarë, ishin mësimdhënësit shqiptarë të qyteteve të ndryshme të Kosovës që ua hapën dyert e shkollave e

fakulteteve. Në këto institucione arsimore, nxënësit shqiptarë nga Mali i Zi, Maqedonia, Presheva, Bujanoci e Medvegja, përveç se do të jenë të mirëpritur, në shumë raste do të jenë edhe të privilegjuar. Këtë të mirë jetësore ata s' do ta harrojnë kurrë. Nuk do ta harrojë as Ymeri. Pas diplomimit në Shkollën Normale të Pejës, i ndërgjegjshëm për misionin që i kishte caktuar vetes, ai do të jetë i gatshëm të punojë e të japë kontributin e vet kudo që kishte nevojë. Pa humbur kohë do të punësohet në shkollën 8 - vjeçare në Korishë, fshatin e njohur atdhedashës e arsimdashës në rrethinë të Prizrenit. Në punën e tij arsimore, përveç dijes dhe edukimit me kulturë qytetare, kujdes të veçantë do t' i kushtojë frymëzimit të nxënësve me dashurinë ndaj atdheut. Për punën e tij me përkushtim, Ymeri do të gëzojë respektin e

onit i



kolegeve e kolegëve, por edhe të prindërve e qytetarëve tjerë. Me qëndrimin dhe sjelljen e tij, ai do të fitojë besimin e kolegës Nermine Rruka, mësimdhënëse e dalluar, me të cilën do të martohet dhe do t' i bëhet shoqe e pandarë e jetës. Lindja e dy djemve, e Arbenit dhe Driteroit, do ta gëzojë e lumturojë këtë familje.

Pas disa viteve, për shkak të një gjendjeje të krijuar pa dashur e pa pritur, Ymeri dhe tre vëllezërit e tij, emigrojnë në SHBA. Edhe atje Ymeri, pa kursyer asgjë nga vetja e familja, do të angazhohet dhe do të japë kontributin e vet për ta ndihmuar Kosovën në përpjekjet e vazhdueshme për t' u çliruar nga pushtimi serb. Ai do të marrë pjesë në protestat e shumta të zhvilluara në SHBA kundër terrorit e krimeve të policisë serbe ndaj popullsisë shqiptare, për njohjen e




faktorëve vendimmarrës amerikanë dhe të faktorëve tjerë ndërkombëtarë me gjendjen e rëndë me të cilën përballej Kosova nën pushtimin serb në vitet e nëntëdhjeta e, veçmas, për fitimin e përkrahjes së këtyre faktorëve për luftën e drejtë mbrojtëse të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Pas Betejës së Prekazit, më 5, 6 e 7 mars 1998, kur lufta e UÇK-së po hynte në një periudhë vendimtare, Ymeri do t' i ngjeshë armët për t' i dalë zot lirisë së atdheut si amanet brezash dhe obligim ndaj Kosovës për bukën, dijen dhe edukatën që i ka dhënë. Përveç kësaj, ai ishte i vetëdijshëm se pa këtë dije dhe pa këtë edukatë, shumë më shumë djem e vajza të krahut të atdheut të

tij, por edhe të krahëve tjerë të atdheut, do ishin tjetërsuar apo do të kishin emigruar!

Kur eprorët ushtarakë të Batalionit Atlantiku kishin dashur ta pengonin Ymerin të mos u bashkohej për shkak të moshës, ai kishte ngulur këmbë duke u thënë: "Mu për shkak të moshës mund të mos kem më rast të luftoj për çlirimin e atdheut. Për këtë rast kam punuar dhe e kam pritur gjatë". I vendosur, siç ishte gjatë gjithë jetës, kishte ardhur dhe bashkë me vullnetarët atlantikas u ishin bashkuar radhëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, duke i shtuar kështu faqet e ndritshme të historisë së luftërave të shqiptarëve për një atdhe të bashkuar, të lirë e të përparuar.

Ëndrra e kapec



Gani Karamanaga

Detari i vjetër atë natë nuk bëri gjumë të mirë. E ndiente veten të lodhur, por doli nga kalaja dhe mbërriti deri në pazar. Mbasi bleu disa gjëra hyri në kafenenë e pensionistëve dhe porositi kafën. Ngadalë u çua në këmbë dhe filloi të ulet rrugës që çon për ranë dhe kala.

Por, ishte i lodhur shumë. Mendoi: “Po ndaloj te dy krojet nën shpinë e Muharrem Ishmit për të pirë ujë...”

Ëndrra 1

Largimi i parë nga shtëpia

I ulur në gurin e kroit filloi ta humbë vetëdijen... Si në mjegulli i kujtohej kur për herë të parë u largua nga shtëpia dhe shkoi në det.

“Kur një paradite vjeshte hipi në një anije me vela, ai kishte vetëm pesëmbëdhjetë vjet. Pragu i luftërave ballkanike. Anija me vela priste forcën e erërave dhe qetas rrëshqiste në midis valëve të detit.

Detari i ri me ato duar të njoma tërhiqte litarin dhe hidhte vështrimin kah Kalaja e Ulqinit, atje ku gjendet shtëpia e tij, ku mbeti fëmijëria e tij... U nda nga prindërit, motrat dhe vëllezërit, shokët, mungesën e të cilëve do ta ndjente në çdo hap.

Në një anë hapësira e pafund e detit dhe në anën tjetër kalaja u bënë dy fusha tërheqëse për të...”

Ishte ky largimi i parë nga shtëpia, nga vendlindja e tij.

Ëndrra 2

Heroina Sulltana Idrizaga Cungu

Rreth 3.000 vetë që morën pjesë në mbrojtjen e Ulqinit, nën komandën e ulqinakëve, Mehmet Becit e Mehmet Gjylit, nga Ulqini si Isuf Sokolit nga

Shkodra, zunë pozitën kryesore në rrethinat e Ulqinit në fshatin Kllazën, ku edhe u zhvillua lufta (më 23 nëntor 1880) për mbrojtjen e Ulqinit.

Megjithatë, forcat turke të cilat ishin shumë më të mëdha, pasi i thyen forcat ulqinake-shkodrane, nuk patën pengesa të tjera për të hyrë në Ulqin. Në këtë luftë u vra Isuf Sokoli.

Tallali (lajmëruesi) e shpalli nëpër qytet se po vjen ushtria turke.

Dervish-Pasha, hyri në qytet më 23 nëntor 1880, kur ulqinakëve të tubuar u drejtua me fjalët:

“Vendimi vjen nga Stambolli... dorëzimi i qytetit është definitiv, duhet t'i nënshtrohen këtij vendimi...”.

Kur mbaroi fjalët, nga grumbulli i qytetarëve të tubuar të Ulqinit, befas doli një femër guximtare. Ajo i doli përpara Pashës, ia kapi frerët e kalit dhe i tha:

“Aman, more Pashë, për hatër të Zotit, mos na shtjer në dorë të hasmit, ma mirë të na mbysësh se sa të na lësh nën shkja...”

Ishte kjo ulqinakja, Sulltana Cungu, gruaja e Mehmet Cungut, këpuçtar, bijë e familjes Idrizaga.

Heshtje.

Populli i tubuar nuk mundi të besojë çka ndodhi.

Përpara Pashës ishte grua rreth pesëdhjetëvjeçare, shikonte drejtë



danit

pa asnjëfarë frike, shikim shprese, lutjeje, por edhe krenarie.

Në atë momente Dervish Pashës i erdhën kujtimet:

“Ishte dekada e pestë e shekullit IX, një vendi i vogël në Bosnjën e Mesme. Ditë e diel. Afër ishte edhe kisha e vogël ortodokse dhe xhamia. Papritmas hyri ushtria e jeniçerëve turkë. Filluan t’i merrnin djemtë prej 12 deri në 14 vjeçarë. E morën edhe lvanin. Pas një kohe të gjithë djemtë i hipën në kalë dhe u përgatitën për t’u nisur.

Prej grumbullit të njerëzve doli nëna e lvanit . U afrua dhe i doli përpara komandantit të jeniçerëve duke thënë:

“Unë nuk e japi djalin tim, mos e merrni”

Ushtarët e larguan dhe vazhduan rrugën.

Pas një jave arritën në Stamboll. Ngadalë, ngadalë filloi mësimi i gjuhës dhe besimit Islam. Ivani e fitoi emrin Dervish.

Kaluan shumë vite , sulltani e emërtoi për Pashën e vilajetit të Shkodrës”

Roja e Pashës iu ofrua gruas, por Dervish Pasha çojti dori dhe i ndaloi ushtarët e tij :

“Askush mos ta prekë, kjo është grua trimëreshë”.

Ëndrra 3

“Lita beg - Stamollaxhi”

U nisën disa djelmosha nga Kalaja, u nisën për të prerë dru në pyll.

Morën kmesat, sakicat, litartë për t’i lidhur.

- Po shkojmë një këtu afër, në Lima, - tha njëri prej tyre.

Në shoqëri ishin: Myzafer Idrizaga, Fejzi Ismajlaga, Shyqyri Karamanaga, Myzafer - Pepo Vogliqi.

Filluan më parë të pastronin pyllin me kmesa, mandej punonin me sakicë.

Por pylli ishte në pronësi private, për çka ata nuk e ditën.

Zëri i tyre, sakica, erdhën deri te pronari, i cili e kishte shtëpinë jo shumë larg.

Në një moment, papritmas erdhi Lita begu i Limanit dhe bërtiti me zë të ashpër:

- Grua, ma bjer çiftin, t’i vras këta!

Të gjithë u frikësuan, por më i vjetëri prej këtij grupi, Myzafer Idrizaga, u kujtua edhe i tha:

- Lita beg - Stamollaxhi, s’e kena ditë se janë drutë tuja!

Këto fjalë pak e qetësuan Ali - Lito begun dhe djelmoshat shpejt vrapuan... Por Lita begu bërtiti edhe një herë:

- Kthenuni! Merrni drutë dhe çoni në shtëpi, se keni bërë mundin dhe mos t’ju shoh më kurrë këtu!

“Bonaca”

Myzafer (Jakup) Idrizaga e filloi ndërtime e një sandalli në kopshtin e tij.

Prej një druje të manit i preu korbat, dërrasat i teri në diell. E bëri konstruktionin dhe e mveshi barkën. Punoi disa muaj. Gati çdo ditë u tubonin fëmijët për të parë si punon Myzaferi. Kur e përfundoi ndërtime, erdhi

koha për ta bartur barkën - sandallin deri në Jalli. Kur e mendoj sot, nuk e kam fare të qartë se si ai sandall, prej 4,5 m gjatësie dhe 1,5 gjerësie, kaloi nëpër rrugicat e ngushta të kalasë!? Një ditë “Bonaca” u mbush me ujë për t’u shenjtëruar.

(Dërrasat mbushen me ujë, afrohen dhe, ashtu mbyllen ndarjet).

Myzaferi punoi edhe disa ditë në Jalli, për vendosjen e direktut dhe velit.

“Bonaca” doli prej Jallie.

Myzaferi e hapi velin dhe filloi të lundronte prapa bedenave të Kalasë, në drejtim të Gurit të Madh dhe Kepit të Bashbylykut.

Ëndrra 4

“Rumija”

ishte pesëvagonëshe. Kryesisht transportonte lloje të ndryshme mallrash në drejtimin Tivar-Ulqin. Pjesa e parë e bashit ,në palmetë ka pasur dy vende për detarët (marinarët). Ndërkaq ,në kabinën në pjesën e kiçit të “Rumisë”,bënin pushim motoristi dhe kapedani. Anijen “Rumija” e punuan Rexhep Beci, kapedan, Hasan (Cano) Lanica motorist,Jakup Idrizaga dhe Hasan (Cano) Karamanaga marinarë. Shpesh kanë ardhur në Ulqin.

Më vonë kapedani i ri ka qenë Xhemal Jakup Idrizaga.

Gati çdo herë që këta detarë planifikonin ta kalonin natën me anijen “Rumija” të lidhur në molin e Ulqinit, deti është trazuar.

Ka mbetur si anekdotë:

“Rumija në Ranë,

Deti në kam ‘..’

Më vonë, në vitet shtatëdhjeta-tetëdhjeta “Rumija” ndërroi pronarët. Fillimisht quhej “Topolica” e mandej Agjencia “Kompas” e përdori për shëtitjen e turistëve me emrin “Sveti Ante”.

Ëndrra 5

Vajza e vogël

Erdhi dhjet vjet pas djalit të tretë, Myzaferit.

Ishte gëzimi i të gjithë familjes.

Kur ishte dhjetë vjeçare dy herë e morën në lundrim me barkën “Rumija” deri në Bokë të Kotorrit.

Detari i vjetër mbylli sytë...

Aty, te dy krojet ishte lundrimi i fundit i Kapedan Jakup Idrizagës.

Klubi i taekwondos "Besa" nga Tuzi vazhdon me përkushtim aktivitetet sportive

Nga fillim i vitit, fitues i dyzetë medaljeve

Tuz – Klubi i Taekwondos "Besa" nga Tuzi, që nga fillimi i vitit 2024, është shumë aktiv me pjesëmarrje nëpër gara të shumta sportive brenda dhe jashtë vendit, duke shënuar rezultate të shkëlqyeshme me dyzetë medalje (të arta, të bronza dhe të argjendta). Sportistët e Klubit "Besa" kanë marrë pjesë në kampionatin Open Zhablak, në kampionatin dimëror në Greqi që u zhvillua në fillim të këtij viti dhe më pas në Austria Open (G Turnament) dhe para pak ditësh (në muajin mars) morën pjesë në Open Zrenjanin.

Trajneri i Klubit të Taekwondos "Besa" Nikollë Gegaj për gazetën Koha Javore u shpreh se pavarësisht mjeteve të pamjaftueshme financiare për të vajtur në të gjitha aktivitetet sportive, ata përipiqen që me aq mundësi sa kanë, të japin maksimumin për të prezantuar punën e klubit me fëmijë nëpër gara të ndryshme.

I pyetur për rezultate që sportistën e 'Besës' arritën në këto kampionate, trajneri Gegaj thotë se kemi të bëjmë me një gjeneratë të re të sportistëve (mbi 60 sportistë të ri) të cilët po japin rezultate të shkëlqyeshme.

"Në kampionatin Open Zhablak dolëm ekipi më i suksesshëm në luftëra, dhe Vendin e Dytë në disiplinën pompse. Ndërsa fituam edhe 24 medalje: 9 të arta, 12 të argjendta dhe 3 të bronza. Kurse në Austria Open 1 medalje të argjendte dhe në Open Zrenjanin, 8 medalje: 3 të arta, 1 të argjendte dhe 4 të bronza

ta" u shpreh trajneri i Klubit "Besa", Nikollë Gegaj.

Ndërkohë, i pyetur se sa është rritur ndër vite interesimi i të rinjve për këtë lloj sporti në Malësi, ai thotë se nga viti në vit numri i sportistëve për sportin e taekwondos shënon rritje.

Gegaj tregon se në punim e sipër është rikonstruksioni (zgjerimi) i objekt sportiv ekzistues I, me përfundimin e së cilit, siç tha ai, numri i sportistëve do të rritet edhe më shumë, pasi infrastruktura e objektit ekzistues ku zhvillohen trajnimet, shërben për një numër të kufizuar të sportistëve.

Z. Gegaj vë në dukje rëndësinë që ka sporti tek fëmijët dhe të rinjtë, sidomos në këtë kohë kur ata janë pasiv, siç tha ai, nga telefonat celularë, tabletë, etj..

"Prandaj ne duhet të punojmë sa më shumë me fëmijët, jo vetëm në taekwondo por në secilin sport. Ne punojmë shumë edhe në edukimin e sportistëve tonë dhe kjo sjell padyshim edhe rezultate. Shpresoj se me këtë lloj edukimi, ne inkurajojmë gjeneratat dhe i mbështesim vërtetë që të mos devijojnë nga rruga e drejt" shprehet Gegaj.

Ndërkaq, ky sport po ushtrohet nga djemtë dhe nga vajzat. Madje viteve të fundit është shtuar numri i vajzave, gjë që, për trajnerin Gegaj tregon se është thyer ajo tabuja kur në fillim të viteve 90-ta, vajzat kanë qenë në numër shumë të vogël.

"Por ne, edhe atëherë kemi nxitur



që të merren me këtë sport dhe sot, jemi krenarë sepse kemi pasur rezultate të shkëlqyeshme edhe me va-



jzat" thotë ai.

Trajneri i këtij klubi tregon se për të shënuar rezultate kërkohet një punë

e vazhdueshme, e pandalshme dhe me shumë përkushtim dhe mund, sidomos kur bëhet fjalë për garat

ndërkombëtare të nivelit të lartë.

"Këtë vit kemi më shumë bashkëpunime me Shqipërinë, me Kosovën, me Bosnjen dhe Hercegovinën në mënyrë që këto mosha të kenë sa më shumë përvojë dhe t'i ngremë në pedestalin më të lartë të rezultateve" shprehet Gegaj.

I pyetur për kushtet në të cilat Klubi "Besa" e zhvillon veprimtarinë sportive, trajneri Gegaj thotë se kushtet ende nuk i kanë të kënaqshme, mirëpo me fillimin e rikonstruksionit të objektit të sportiv, kushtet priten të përmirësohen dukshëm.

"Investimi fillestar për këtë objekt është personalisht nga buxheti im një pjesë nga diaspora para dy-tre vjetësh" shprehet ai.

Trajneri Gegaj tha se vitin e kaluar kishte një projekt shumë afër realizimit i cili fatkeqësisht, siç tha ai, nuk është realizuar.

"Edhe pse Ministria e Sportit në bashkëpunim me Komunën e Tuzit e premtoi. Megjithatë, ne ende nuk kemi humbur shpresat nga ajo gjë që të realizohet ai projekt. Bëhej fjalë për një shumë prej 40 mijë eurosh. 10 mijë për pajisje, sepse momentalisht jemi shumë deficitar. Pra, nëse s'kemi pajisjet e duhura, ne nuk mund të ecim para" shpreh Gegaj.

Ai u shpreh optimist se në këtë drejtim do ta ndihmojë komuna dhe organizatat e tjera brenda dhe jashtë vendit, duke apeluar tek organet komunale qa ta shtyjnë para projektin e tyre të realizimit të objektit sportiv.

"Sepse në vjeshtë ne do të prisnim një numër më të madh, pra do ta dyfishonim numrin e fëmijëve, por dhe do të hapte mundësi të reja që të punësojmë ndonjë të ri që të asistojë meje sepse aktualisht të gjithë që më ndihmojnë, janë vullnetarë.

I pyetur për ecurinë e punimeve në këtë objekt sportiv, trajneri Gegaj thotë se faza e parë e punimeve, afro 70 për qind është përfunduar, ndërsa ende mungojnë tualetet, dhomat e zhveshjeve, fasadat, ndriçimi dhe disa punime të tjera të domosdoshme.

Z. Gegaj thotë se ky objekt shume-funksional do të shërbej si qendër edhe për klubin e çiklizmit, kajakut, vëtbrotjtjes, sporti i xhudos, boksit, vallëzimit, fitnesi etj..

t. u.

Në seancën e parë të rregullt të Kuvendit të Komunës së Gucisë për vitin 2024

U prezantuan, shqyrtua u miratuan një vistër aktesh normative të organeve të qeverisjes lokale, institucioneve dhe organizatave publike



Guci - Në seancën e parë të rregullt të Kuvendit të Komunës së Gucisë për vitin 2024, të mbajtur të hënën më 15 prill 2024, në sallën e komunës për seanca, takime e tubime, në të cilën ishin të pranishëm 27 këshilltarë prej gjithsej 30 sa numëron Kuvendi, u prezantuan, shqyrtuan dhe u miratuan një vistër aktesh normative të punës së organeve të qeverisjes lokale, institucioneve dhe organizatave publike që punojnë dhe veprojnë në trevën e Komunës.

Para fillimit të punës së seancës, të cilën e hapi kryetari i Kuvendit, Bu-

jar Hasangjekaj, u verifikua mandati i këshilltarit të ri Edvin Bektешеviq nga lista zgjedhore e subjektit politik "Socialdemokratët Ivan Brajoviq - Ne vendosim me konsekuencë për Gucinë" në vend të këshilltarit në dorëheqje Irfan Dervisheviq nga lista e të njëjtit subjekt politik i cili u zgjedh sekretar i Sekretariatit për Planifikim hapësinor dhe mbrojtje të mjedisit.

Më pas, këshilltarët e pranishëm pa vërejtje dhe njëzëri miratuan procedurave: nga seanca e tretë e rregullt e KK-së, e mbajtur me 22 nëntor 2023 dhe nga seanca e katërt

e rregullt e KK-së e mbajtur më 29 dhjetor 2023 dhe në vazhdim shqyrtuan dhe njëzëri miratuan rendin e ditës të propozuar prej 13 pikash, i cili pësoi ndryshime sepse nga puna e seancës në propozim të kryetarit të Komunës Sanell Balliq u tërhoqën pikat 5, 6 dhe 7 në radhën e rendit të ditës që kanë të bëjnë me tri propozim vendime: për dhënien e pëlqimit për formimin e bashkësive lokale (vendore) në: Vuthaj, Doli dhe Dosugjë.

Seanca filloi punën me shqyrtimin e tri pikave të para të rendit të ditës,

n dhe katesh të ucioneve ke



me informacionet mbi punën e tri institucioneve publike që punojnë dhe veprojnë në Komunën e Gucisë në vitin 2023. Informatën për gjendjen dhe mbrojtjen primare shëndetësore në Komunën e Gucisë në vitin 2023, me të cilën të pranishmit në seancë në mënyrë koncize dhe analitike i njoftoi drejtori i Shtëpisë së shëndetit “Dr. Branko Zogoviq” në Plavë, Dr. Armen Pejçinoviç, në kuadër të së cilës punon dhe vëpron Stacioni shëndetësor në Guci. Lidhur me informatën e prezantuar u zhvillua polemikë dhe dialog i

ashpër verbal në mes të mjekes së vetme të përhershme në Ambulancën e Gucisë, Dr. Harisa Llalliçiq, dhe drejtorit të Shtëpisë së shëndetit në Plavë, Armen Pejçinoviç, të cilët me të dhëna verbale e kundërshtuan njëri-tjetrin në deklarata për gjendjen faktike shëndetësore në Komunën e Gucisë. Përkitazi me informatën në fjalë, mendimet e veta i parashtruan edhe ca këshilltarë pjesëmarrës në diskutim.

Informatën për gjendjen e sigurisë në territorin e Komunës së Gucisë në vitin 2023, e prezantoi dhe e argumentoi me të dhëna faktike të shprehura me fjalë dhe shifra, kryeshefi i Departamentit të sigurisë në Plavë, Stacioni policor në Guci, Mehmed Kollashinac, për të cilën mendimet, shikimet dhe vlerësimet e veta në mënyrë konstruktive i shprehën ca këshilltarë në diskutimet e veta.

Ndërkaq, informatën për mbrojtjen e fëmijëve dhe mbrojtjen sociale për territorin e Komunës së Gucisë në vitin 2023, në mënyrë kronologjike e parashtrori para të pranishmëve në seancë menaxherja e Qendrës për punë sociale në Plavë, zonja Merima Balliq, informatë kjo për të cilën nuk pati të interesuar për diskutim.

Seanca e cila zgjati katër orë, pastaj vazhdoi punën me Propozim vendimin për miratimin e Programit të rregullimit hapësinor të Komunës së Gucisë për vitin 2024, të cilin në mënyrë analitike dhe kronologjike e prezantoi dhe e argumentoi me shifra dhe fjalë sekretari i Sekretariatit për planifikim hapësinor dhe mbrojtje të mjedisit, Irfan Dervisheviç, lidhur me të cilin në diskutim morën pjesë këshilltarët Adell Damjanoviç e Ferka Jaroviç dhe kryetari i Komunës Sanell Balliq. Propozim vendimi me votim të hapur u miratua njëzëri.

Raportin mbi punën e kryetarit të Komunës së Gucisë, organeve dhe shërbimeve të qeverisjes lokale për vitin 2023, në mënyrë koncize, analitike dhe kronologjike e prezantoi dhe e argumentoi me të dhëna të bollshme të shprehura me shifra dhe fjalë, kryetari i Komunës, Sanell Balliq, i cili përmes elaborimit disaminutësh të pranishmit në seancë i njoftoi me punën e tij dhe të organeve e shërbimeve të qeverisjes lokale

në vitin paraprak 2023. Përkitazi me raportin, vlerësimet dhe shikimet e veta ndaj raportit, i dhanë këshilltarët Adell Damjanoviç dhe Llakiq Baboviç. Raporti nga këshilltarët e pranishëm u miratua njëzëri.

Edhe katër raportet tjera mbi punën dhe gjendjen financiare të institucioneve dhe organizatave publike që veprojnë në trevën e Komunës së Gucisë i prezantuan drejtuesit dhe menaxherët e tyre: Raportin e punës së SHPK “Veprimtarit komunale” në Guci me raportin financiar për vitin 2023, e parashtrori drejtori Edin Mulliq, mbi të cilin në diskutimet e veta konstruktive i shprehën vërejtjet, sugjerimet dhe këshillimet këshilltarët: Adell Damjanoviç, Seniha Kollenoviç, Llakiq Baboviç dhe Ferka Jaroviç. Raporti u miratua njëzëri. Raportin mbi punën e Organizatës turistike në Guci dhe raportin e saj financiar për vitin 2023, të pranishmit në seancë në pika të shkurtra i njoftoi drejtori Getoar Gjonbalaj, përkitazi me përmbajtjen e të cilit në diskutimet e veta mendimet, shikimet dhe vlerësimet i dhanë këshilltarët, Adell Damjanoviç dhe Ferka Jaroviç. Raporti është miratuar njëzëri nga këshilltarët e pranishëm. Raportin e punës së Qendrës për kulturë në Guci dhe raportin financiar të saj për vitin 2023, me të dhëna dhe argumente të shprehura me fjalë dhe shifra e prezantoi drejtoresha Llejlla Balliq, mbi të cilin mendimet e veta i dhanë këshilltarët diskutant Adell Damjanoviç dhe Ali Kukaj, të cilët me shprehje dialogjike i konkretizuan mendimet e veta mbi punë e Qendrës për Kulturë, dhe Raportin e punës së shërbimit të Kuvendit të Komunës së Gucisë për vitin 2023, në mënyrë koncize dhe kronologjike e parashtrori kryetari i Kuvendit Bujar Hasangjekaj, i cili nga këshilltarët e pranishëm u miratua njëzëri.

Në pikën e fundit të rendit të ditës - pyetje dhe përgjigje të këshilltarëve, pyetje parashtruan këshilltarët: Adell Damjanoviç, Seniha Kollenoviç, dhe Zef Dushi, në të cilat përgjigjet i dhanë: Drejtori për investime dhe rregullim hapësinor, Asdren Çelaj, Kryetari i Komunës, Sanell Balliq, dhe kryetari i Kuvendit të Komunës, Bujar Hasangjekaj. **Shaban Hasangjekaj**

ENTI I TEKSTEVE DHE I MJETEVE MËSIMORE, PODGORICË, Novaka Millosheva 36

Në bazë të nenit 4, pika 2, dhe nenit 6 të Rregullores mbi procedurën e sigurimit, vlerësimit dhe miratimit e të përgatitjes së teksteve dhe mjeteve mësimore / “Gaz. zyrtare e RMZ”, nr. 31/2004, 38 /2005, 22/2007 dhe „Gaz. zyrtare MZ“ nr. 84/2009 dhe 23/2012/, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore (në tekstin e mëtejshëm: Botuesi) shpall

KONKURSIN

për sigurimin e dorëshkrimeve në gjuhën shqipe

Për shkollën fillore:

1. Gjuhë shqipe për klasën e tretë - Teksti mësimor, Fletorja e punës dhe Libri i mësuesit,
2. Gjuhë shqipe për klasën e shtatë - Teksti mësimor, Fletorja e punës dhe Libri i mësuesit,
3. Gjuhë shqipe për klasën e tetë - Teksti mësimor, Fletorja e punës dhe Libri i mësuesit,
4. Gjuhë shqipe për klasën e nëntë - Teksti mësimor, Fletorja e punës dhe Libri i mësuesit.

KUSHTET E KONKURISIT:

1. Në konkursin për sigurimin e dorëshkrimeve të teksteve mësimore (në tekstin e mëtejshëm: Konkurs) mund të marrin pjesë shtetasit e Malit të Zi si dhe shtetasit e huaj, në qoftë se janë në ekip (grup pune) me shtetasit e Malit të Zi.
2. Ekipi i punës duhet të ketë më së paku dy anëtarë, nga të cilët njëri duhet të jetë punonjës shkencor, kurse tjetri praktikant në fushën përkatëse.
3. Në Konkurs nuk mund të marrin pjesë persona që janë të punësuar tek Botuesi, as edhe persona që marrin pjesë në organet kompetente që miratojnë tekstat.
4. Dorëshkrimet duhet të jenë sipas Programit të ri arsimor për lëndët dhe klasat e caktuara, (Programet e miratuara nga Këshilli Kombëtar i Arsimit në korrik 2017) si edhe sipas Standardeve për punimin e teksteve dhe mjeteve mësimore.
5. Dorëshkrimet nga 1 deri 4 duhet të përmbajnë detyrimisht:
 - përmbajtjen komplete të Tekstit mësimor/Gjuhë shqipe, Fletores së punës/ Librit të mësuesit (titujt e kapitujve, nëntitujt...) dhe
 - 100 % të dorëshkrimit.

Shënim: Në qoftë se në dorëshkrim gjenden vepra të mbrojtura të autorit ose pjesë të tyre, autorët e teksteve janë të detyruar të sigurojnë dakordësinë (në formë të shkruar) nga bartësit e të drejtave për botim.

6. Dorëshkrimi dorëzohet në 6 (gjashtë) ekzemplarë të shtypur.
7. Dorëshkrimet nënshkruhen me shifër dora vetë, nga jo më pak se 2 (dy) fjalë të shkruara qartë. Autorësia vërtetohet me kopjen identike të dorëshkrimit dhe të nënshkrimit të shifrës, në afatin prej 8 (tetë) ditësh nga dita e shpalljes së rezultateve të Konkursit.
Afati i deshifrimit të dorëshkrimit vazhdon nga dita e shpalljes së rezultateve të Konkursit. Nëse deshifrimi nuk kryhet në afatin e caktuar, humbet e drejta e fituar në Konkurs.
8. Afati i dorëzimit të dorëshkrimeve nga 1 deri 4 është data 22 nëntor 2024 deri në ora 15:00 në hapësirat e Entit. Dorëshkrimet që do të dorëzohen pas mbylljes së Konkursit, nuk do të shqyrtohen.
9. Mbi rezultatet e Konkursit, Botuesi do të njoftojë pjesëmarrësit në afatin prej 90 ditësh nga mbyllja e Konkursit, përmes mjeteve të informimit, në të cilat është shpallur konkursi.
10. Pjesëmarrësit e konkursit, dorëshkrimet e të cilëve do të jenë të pranuar, i japin Botuesit të drejtën ekskluzive të botimit të dorëshkrimit dhe përkthimin në alfabetin e Brajtit, gjithnjë deri sa të ekzistojë një nevojë e tillë.
11. Autorët janë të detyruar që dorëshkrimet me të cilat marrin pjesë në konkurs t’i paraqesin në gjuhën standarde shqipe.
12. Autorët, dorëshkrimet e të cilëve pranohen në këtë konkurs, do të lidhin me Botuesin kontratën, me të cilën rregullohen të drejtat dhe detyrimet mes palëve, sipas dispozitave të Rregullores mbi honoraret, shpërblimet dhe kompensimet e autorëve nga Botuesi.
13. Dorëshkrimet që nuk plotësojnë kushtet e Konkursit, nuk do të shqyrtohen.

Programet mësimore (faqja ueb e Entit të Shkollimit në Mal të Zi), kurse Standardi për tekstet dhe mjetet mësimore janë në faqen ueb të Entit të Teksteve dhe të Mjeteve Mësimore (www.zuns.me).

Informatat në lidhje me Konkursin mund të fitohen me telefon në numrat:

020/210-185 dhe 020/230-413.



JOB VACANCY ANNOUNCEMENT

LOCATION: Based in Tirana, Albania
CLASSIFICATION: Full-time / Personal Services Contractor (PSC)
POSITION: Training Manager

OPENING DATE: Tuesday, April 16, 2024
CLOSING DATE: Tuesday, April 30, 2024

The United States Peace Corps seeks a Training Manager (TM) to provide overall management and supervision of Peace Corps Albania and Montenegro's training programs for Trainees (pre-service training) and Volunteers (in-service trainings and other training events) as well as for staff development training events. The functions include leading the design of effective training programs; creating effective learning environments for Trainees, Volunteers and staff; planning, directing, supervising and monitoring training of trainers, pre-service training programs and in-service training events as appropriate; coordinating the integration of training components effectively into training programs; helping to assure the safety and security of Trainees and Volunteers; supervising training staff members as appropriate; and reporting on training programs.

The TM position will be based in Tirana, Albania, and will serve Peace Corps both in Albania and Montenegro.

Qualifications and Evaluation Criteria

Candidates must meet all Requirements. Candidates will be further evaluated for exceeding the minimum requirements, as well as additional qualifications presented.

Requirements

- **Education:** University degree in a field a field of study related to the position. Preference will be given to candidates with relevant experience and a relevant graduate degree.
- **Experience:** + 5 years of related work with relevant government agencies, not-for-profit organizations, or private businesses. Experience in designing, organizing, and delivering training programs, particularly to diverse people from a variety of backgrounds, using non-formal education techniques. It is preferred for TM to have experience in preparing and implementing training budgets.
- **Language Proficiency:** Required fluency in English and Albanian, both spoken and written. It is also preferable for the TM to speak and write in Montenegrin.
- **Computer Skills:** Excellent computer skills including Word processing and Excel spreadsheet programs.

Additional Requirements

- Ability to maintain a clean background check/security badge.
- Valid passport and ability to travel internationally.

Preferred Qualifications:

- Demonstrated organizational and communication skills, intercultural competence, diversity, equity, inclusion, and accessibility related skills.
- Demonstrated ability to synthesize, interpret, and apply regulations.
- Willingness to take the initiative; and has excellent teamwork skills.

Compensation

The Peace Corps is an equal opportunity employer and it is the policy of the Peace Corps to provide equal opportunity in employment to all persons, to prohibit discrimination because of race, color, religion, sex, national origin, age, disability, or veteran status. It is the policy of Peace Corps Albania and Montenegro to pay wages similar to those paid by other local employers for similar work.

TO APPLY FOR THIS JOB:


Applicants must submit their application documentation to the Director of Management and Operations by, **COB, Tuesday, 30 April 2024**, to AL-Information@peacecorps.gov.

All submitted applications will include:

- Application packages must include a current resume or CV, a cover letter explaining your qualifications for the position, & at minimum three professional references, certificates, or other documents that can demonstrate your skills & abilities.
- Please ensure to provide an English translated version of all documents that are in Albanian or Montenegrin.

Only applications from qualified applicants received on or before COB, Tuesday, 30 April 2024 will be considered. Only qualified candidates will be contacted.

The Peace Corps is an Equal Opportunity Employer. For more information, please visit: <https://www.peacecorps.gov/albania/contracts/>



“Koha Javore” në
versionin online,
mund ta lexoni
në linkun:

www.kohajavore.me

